

Handwritten signature and scribbles in the top left corner.

KUVENDI
NR 1867 DATE 07.05.19



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. 2498/2 Prot.,

Tiranë, më 03 .05 .2019

LËNDA: Dërgim i raportit “Mbi gjendjen e sistemit gjyqësor dhe veprimtarinë e Këshillit të Lartë Gjyqësor për vitin 2018”

DREJTUAR: **Z. GRAMOZ RUÇI**

KRYETARI I KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

TIRANË

I nderuar Z. Ruçi,

Duke shprehur konsideratën për veprimtarinë e institucionit që Ju drejtoni, bazuar në nenin 82 të Ligjit Nr.115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, lutemi gjeni bashkëlidhur raportin “Mbi gjendjen e sistemit gjyqësor dhe veprimtarinë e Këshillit të Lartë Gjyqësor për vitin 2018”.

Duke Ju falenderuar,

KRYETARE

Handwritten signature of Naureda Elagami
NAUREDA ELAGAMI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

Nr. 69, datë 03.05.2019

**PËR
MIRATIMIN E RAPORTIT MBI GJENDJEN E SISTEMIT GJYQËSOR DHE
VEPRIMTARINË E KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR PËR VITIN 2018**

Këshilli i Lartë Gjyqësor mbështetur në nenin 82 të ligjit nr.115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”,

VENDOSI:

1. Miratimin e Raportit “Mbi gjendjen e sistemit gjyqësor dhe veprimtarinë e Këshillit të Lartë Gjyqësor për vitin 2018”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

KRYETARE

NAUREDA LLAGAMI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. 2498 prot
dt. 03.05.2019

RAPORT

MBI

**GJENDJEN E SISTEMIT GJYQËSOR DHE
VEPRIMTARINË E KËSHILLIT TË LARTË
GJYQËSOR PËR VITIN 2018**

Tiranë më datë 03.05.2019



(Miratuar me Vendimin Nr.69, datë 03.05.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor)

PËRMBAJTJA

1.HYRJE.....	3
1.1 Krijimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe garancitë institucionale për një pushtet gjyqësor të pavarur, të përgjegjshëm dhe efikas	
1.2 Përmbledhje e problematikave kryesore që analizohen në raport	
1.3 Kuadri Ligjor, fushëveprimi, kompetencat dhe pritshmëria ndaj KLGJ-së	
2.RAPORTIM MBI VEPRIMTARINË E KLD-së.....	12
2.1 Veprimtaria e Inspektoratit (IKLD)	
2.2 Vlerësimi i veprimtarisë profesionale dhe etike të gjyqtarëve	
2.3 Pezullime të gjyqtarëve nga detyra	
2.4 Vlerësimi profesional i gjyqtarëve në kudër të procesit të rivlerësimit kalimtar	
2.5 Transferime të gjyqtarëve	
2.6 Kërkesat për delegime të gjyqtarëve në gjykata të tjera	
2.7 Përmbledhje	
3.RAPORTIM MBI VEPRIMTARINË E KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR.....	18
3.1. Mbledhjet plenare	
- vakumi në sistemin e drejtimit në gjykata si pasojë e shkarkimit të kryetarëve të gjykatave	
- caktimi i përkohshëm të gjyqtarëve prane Gjykatave të Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar	
- emërimi dhe caktimi në detyrë i magistratëve që kanë përfunduar në vitin 2018 dhe pranimet e reja	
- ngritja e strukturës për vijimin e bashkëpunimit me institucionet e rivlerësimit kalimtar	
- verifikimi i kriterëve ligjore për kancelarët në detyrë	
- ngritja e komisioneve të përherëshme dhe përkohëshme	
- vlerësimi i situatës dhe ngritja e komisionit për shqyrtimin e ankesave kundër vendimeve të Kryeinspektorit të IKLD	
- trajtimi i kërkesave për delegime të gjyqtarëve në gjykata të tjera	
- ngritja e komisioneve dhe strukturës administrative të KLGJ-së	
3.2 Veprimtaria e Komisioneve të Këshillit të Lartë Gjyqësor	
3.2.1 Komisionet e përherëshme	
- Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit	
- Komisioni i Disiplinës	
- Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale	
- Komisioni i Zhvillimit të Karrierës	
3.2.2 Komisionet e përkohshme	
4. ANALIZA MBI SITUATËN E GJYKATAVE NË SHKALLË VENDI.....	28
4.1. Analiza e të dhënave statistikore	
- ngarkesa e gjykatave dhe backlog në shkallë vendi	
- shpejtësia e trajtimit të çështjeve treguesit CR dhe DT	
- përdorimi i sistemit audio në gjykata	
- vonesat në dorëzimin e vendimeve gjyqësore të arsyetuara	
- efekti i ndryshimeve në legjislacion	
- analiza mbi situatën në Gjykatën e Lartë	
- përmbledhje	
4.2 Veprimtaria e ZABGJ dhe burimet njerëzore në gjykata	
- shpenzime personeli	
- shpenzime operative	
- shpenzime kapitale	
- nevojat për sisteme të reja TIK	
- pasqyrimi i organikave të gjykatave në shkallë vendi sipas dekretit dhe situatës faktike	
- vlerësim i situatës për burimet njerëzore të administratës gjyqësore	
- përmbledhje	
5. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME.....	54

Ky raport u përgatit nga Grupi i Punës i ngritur për këtë qëllim me Urdhrin Nr.129 datë 01.04.2019 “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e projekt-raportit mbi gjendjen e sistemit gjyqësor për vitin 2018”, i përbërë nga znj. Antuen Skënderi, znj. Luljeta Laze, z. Xhevdet Haxhiu, z. Vildan Kaloshi dhe znj. Aurora Ndreu.

Raporti u shqyrtua dhe u miratua nga Komisioni i Përhershëm pranë KLGJ-së, për Planifikimin Strategjik, Administrimin dhe Buxhetin, i drejtuar nga Kryetare e Këshillit znj. Naureda Llagami dhe anëtarët e tij znj. Fatmira Luli dhe z. Medi Bici.

Në përfundim raporti u miratua në mbledhjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor me Vendimin Nr.69 datë 03.05.2019

1 HYRJE

1.1 KRIJIMI I KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR DHE GARANCITË INSTITUCIONALE PËR NJË PUSHTET GJYQËSOR TË PAVARUR, TË PËRGJEGJSHËM DHE EFIKAS

Reforma në sistemin e drejtësisë u projektua duke mbajtur parasysh deformimet që kishte pësuar sistemi dhe duke synuar të adresojë në mënyrë sistematike praktika kompromentuese si pandëshkueshmëria, mungesa e transparencës, ndikimi politik dhe korrupsioni. Në të njëjtën kohë reforma synoi të ofrojë një infrastrukturë të re institucionale e cila së bashku me mekanizmat monitorues do të garantojë rritjen e efikasitetit dhe profesionalizmit në gjykata. Ndryshimet Kushtetuese të vitit 2016 u pasuan me miratimin e një pakete ligjore, e cila solli ndryshime thelbësore në organizimin dhe funksionimin e aktorëve të sistemit të drejtësisë, si rezultat i të cilave u krijua një strukturë e re kushtetuese – Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ).

Duke mbajtur parasysh pritshmëritë për reformimin e sistemit të drejtësisë KLGJ-ja në ndryshim nga institucioni pararendës, ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë (KLD) vjen me një mandat më të gjerë. Ndërkohë që vijon të ketë si edhe organi pararendës kompetenca lidhur me emërimin, vlerësimin profesional dhe etik, ngritjen në detyrë, transferimin, dhënien e masave disiplinore ndaj gjyqtarëve, KLGJ tashmë në ndryshim nga organi pararendës, propozon dhe administron buxhetin e gjykatave, si dhe drejton dhe kujdeset për administrimin e gjykatave dhe të administratës gjyqësore, duke përfshirë edhe Gjykatën e Lartë. Tani kemi kompetenca të mirë përcaktuara në drejtim të rregullimit të brendshëm të gjykatave, të administratës gjyqësore, financave të tyre ashtu dhe përgatitjes profesionale të gjyqtarëve. Ky mandat i zgjeruar me kompetenca të domosdoshme për një strukturë të cilës i besohet qeverisja e sistemit është kompletuar me ndryshimet në përbërje të këshillit, mënyrën e përzgjedhjes të anëtarëve duke favorizuar kështu rritje të cilësisë të vendimmarrjes dhe duke vendosur premisat për të garantuar një sistem të pavarur, të përgjegjshëm, cilësor dhe eficient, duke siguruar transparencë dhe akses për qytetarët.

Fuqizimi i këtij organi qeverisës për pushtetin gjyqësor, i sanksionuar tashmë në kuadrin ligjor në formën e kompetencave të mirë përcaktuara, paraqitet si një platformë institucionale e cila në bashkëpunim edhe me institucione të tjera, veçanërisht me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, Shkollën e Magjistraturës, dhe Ministrinë e Drejtësisë duhet të qasin strategjikisht problemet e sistemit, si dhe të monitorojnë dhe garantojnë vlerat dhe cilësitë e një sistemi gjyqësor të paanshëm, të drejtë dhe të pa korrumpuar i cili merr krenari nga gjyqtarë që punojnë cilësisht, me dinjitet dhe eficientë.

Në këtë drejtim, në funksion të *pavarësisë, përgjegjshmërisë, eficientës dhe transparencës*, disa risi paraqiten për herë të parë në kompozimin institucional të KLGJ-së:

- ndarja e qartë e detyrave dhe përgjegjësi midis institucioneve të drejtësisë shërben jo vetëm në funksion të *pavarësisë institucionale*, por edhe si një hap për *përgjegjshmëri dhe eficientë më të lartë*.
- rishikimi i përbërjes së KLGJ-së kombinon eksperiencën e anëtarëve që vijnë nga shoqëria civile, fusha akademike dhe avokatia. Ky kompozim sjell disa

avantazhe ku për herë të parë sjell një barometër të brendshëm për efektet e vendimmarrjes së KLGJ-së tek “përdoruesit” e sistemit, paraqet një përpjekje për të luftuar korporatizmin në gjyqësor dhe ofron një profilizim i cili reflektohet edhe në kompozimin e komisioneve sipas ekspertizës së anëtarëve. Angazhimi me kohë të plotë i anëtarëve dhe të gjitha risitë e lartpërmendura ndikojnë pozitivisht në funksion të *përgjegjshmërisë dhe cilësisë së vendimmarrjes*.

- mungesa e Presidentit të Republikës dhe Ministrit të Drejtësisë mes radhëve të anëtarëve shënjon një hap tjetër drejt *pavarësisë dhe paanësisë* në përpjekje për të evituar çdo ndikim të mundshëm nga politika.
- ngritja e komisioneve të përhershme me fuqi vendimmarrëse gjithashtu synon të rrisë *profesionalizmin, efikasitetin dhe pavarësinë e brendshme*.
- forma kolegjiale e KLGJ-së, së bashku me *platformën e transparencës*, janë gjithashtu dy parakushte për një *vendimmarrje të drejtë* dhe që e sjellin qeverisjen e gjyqësorit më pranë publikut (*rritje e aksesit*).

Duhet mbajtur në konsideratë se garancitë ligjore dhe kompozimi institucional nëse nuk ndërthuren me një vendimmarrje vizionare të drejtuar nga zgjidhjet, dhe mbi të gjitha një vendimmarrje të drejtë të vetë KLGJ-së, nuk mund të garantojnë një sistem gjyqësor të bazuar në vlera. Në funksion të *një sistemi funksional, të pa anshëm, me integritet dhe me fokus qytetarin*, Këshillit të Lartë Gjyqësor i dalin disa detyra parësore nëpërmjet të cilave KLGJ duhet të angazhohet për:

- *mbrojtjen e statusit të gjyqtarit*, duke filluar që nga procesi i emërimit dhe promovimit mbi baza meritokratike, trajtimit financiar të denjë dhe zhvillimit të qëndrueshëm të karrierës, duke mos harruar dhe incentivat shtesë përballë përgjegjësisë në rritje. Kjo qasje nuk është një privilegj i veçantë për gjyqtarët, por është një trajtim proporcional i cili synon dhënien e një drejtësie të pavarur. Rritja e dinjitetit të magjistratit (gjyqtarit) dhe qëndrueshmëria në karrierë, minimizon arsyet e kompromentimit duke përmirësuar cilësinë e sistemit. Ushtrimi i duhur i kompetencave të komisioneve të Zhvillimit të Karrierës, Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, si dhe Komisionit Disiplinor duhet të sjellë si rezultat një mekanizëm funksional për kontrollin dhe pastrimin e vetë sistemit në rastet kur vërehen persona të padenjë, por në të njëjtën kohë duhet të garantojë mbështetje dhe promovim për gjyqtarët me integritet.
- *sigurimin e qëndrueshmërisë dhe profesionalizmit të administratës gjyqësore*, duke ofruar mundësitë e duhura për rritjen e kapaciteteve dhe përvetësimin e metodave profesionale të administrimit gjyqësor dhe që ndikojnë cilësisht në praktikën e punës. KLGJ synon të ngrejë metodika pune të unifikuara për të gjitha gjykatat, në mënyrë që praktikat e fragmentuara, amatore, të bëhen të papranueshme duke mos lejuar hapësira për paqartësi, mungesë transparence dhe korrupsion. Përmirësimi i cilësisë së administratës gjyqësore ndikon drejtpërdrejt në dhënien e shërbimit ndaj qytetarëve.
- *trajtimin e backlog-ut (stokut të çështjeve gjyqësore) me masa emergjente* duke mbajtur parasysh numrin e madh të çështjeve të mbartura¹ dhe të reja që regjistrohen veçanërisht në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë, me 6709 çështje të mbartura, Gjykatën e Apelit Tiranë, me 8271 çështje, Gjykatën e Apelit Administrativ, me 12217 çështje dhe Gjykatën e Lartë, me 28863 çështje të mbartura në vitin 2019. Vonesa në trajtimin e çështjeve gjyqësore sjell një sistem të mbingarkuar i cili jep efekte në drejtësi të vonuar për qytetarët. Si pjesë e këtyre efekteve duhet të mbahet në konsideratë dhe procesi i rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve (vettingu) i cili krijon mungesë burimesh njerëzore, duke

¹ 75803 çështje të mbartura në vitin 2019

krijuar “vakanca fiktive”. Aktualisht ka një numër gjyqtarësh të cilët *de jure* janë në detyrë dhe paguhen pjesërisht për shkak se pas përfundimit të procesit të vlerësimit në instancat e shkallës së parë (Komisionit të Pavarur të Kualifikimit) këta gjyqtarë janë pezulluar nga detyra deri në një vendim përfundimtar nga Komisioni i Posaçëm i Apelit, ndërsa *de facto* këta gjyqtarë nuk janë në detyrë, pra nuk kontribuojnë në shqyrtimin dhe evadimin e çështjeve gjyqësore. Këshilli i Lartë Gjyqësor është i angazhuar të mbështesë procesin e vettingut dhe bashkëpunojë me institucionet përgjegjëse që jo vetëm të pastrojë sistemin nga gjyqtarët e korruptuar, por edhe të ruajë funksionalitetin e gjykatave sepse mungesa e këtyre të fundit cenon mjetet e brendshme efektive dhe aksesin në drejtësi për qytetarët.

- ***krijimin e hartës gjyqësore të re***, e cila do të mundësojë një vlerësim dhe rishpërndarje të burimeve njerëzore në gjykata, e parë kjo në raport me numrin e çështjeve të regjistruara në një rreth të caktuar. Synimi mbetet maksimizimi i burimeve njerëzore dhe financiare, rritja e efikasitetit të gjykatave, përmirësimi i shpejtësisë së gjykimit dhe aksesit në drejtësi për qytetarët. Kjo e fundit është një ndërmarrje e madhe për të cilën mbështetemi tek ekspertiza dhe standardet e certifikuar nga Komisioni Evropian për Efikasitetin në Drejtësi (CEPEJ) Këshillit të Evropës, EURALIUS dhe USAID.
- ***krijimin e Gjykatës së Posaçme për Gjykimin e Veprave Penale të Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar***, e cila është jo vetëm një detyrim ligjor prioritar pas ngritjes së KLGJ, por vjen si domosdoshmëri për arritjen e rezultateve të shpejta dhe të prekshme në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, të cilat qëndrojnë në krye të listës së prioriteteve për hapjen e negociatave me Bashkimin Evropian. Këto prioritete kërkojnë jo vetëm struktura të posaçme por edhe specializimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve. Në këtë kuptim bazuar edhe në eksperiencat e rajonit (si p.sh. Kroacia) një koordinim domethënës po kryhet edhe me Këshillin e Lartë të Prokurorisë.
- ***rritjen e transparencës dhe besimit të publikut tek gjyqësori***, kjo mbetet një pikë e dobët për sistemin gjyqësor shqiptar. Deri më sot qasja me publikun ka qenë se gjykata flet me vendime. Ndërkohë që teknologjia e informacionit dhe interesi mediatik është rritur, komunikimi i gjykatave me publikun ka mbetur i cunguar duke bërë që vendimmarrja e këtyre të fundit të bëhet objekt interpretimi nga aktorë të jashtëm të cilët ndikojnë kuptueshmërinë për publikun, ndërkohë që vetë gjykata mbetet pa zë. Në këtë drejtim disa hapa konkretë janë të mundshëm dhe të domosdoshëm, si krijimi i rregullave për komunikimin me publikun dhe median, bërja funksionale e faqeve të internetit dhe përditësimi i tyre në kohë reale nga ana e gjykatave, përdorimi i sistemit audio në mënyrë të rregullt, krijimi i një portali elektronik gjithëpërfshirës për të gjithë gjyqësorin nga ana e KLGJ-së, bërja publike e vendimeve të vetë KLGJ-së, publikimi i vendimeve gjyqësore në kohë, caktimi i një anëtari të KLGJ për marrëdhënien me publikun (tashmë i zgjedhur), si dhe i një gjyqtari me të njëjtin rol në të gjitha gjykatat me juridiksion apeli, këta përfaqësues duhet të ofrojnë informacion faktik sidomos për çështjet me interes publik. Mjeti më i mirë për ndryshimin e perceptimit të publikut dhe rifitimin e besimit të tij është pasqyrimi i nismave të ndërmarrja dhe paraqitja e rezultateve të arritura nga KLGJ dhe gjykatat. Ndaj ngritja e këtyre mekanizmave transparence është prioritet i saj që do të sjellë efekte pozitive për vendimmarrje të përgjegjshme dhe të drejtë nga çdo aktor i sistemit.

- **rritjen e buxhetit dhe përmirësimin të infrastrukturës në gjykata**, të cilat deri më sot raportohen me problem në 16 gjykata.² Infrastruktura në gjykata është problematike jo vetëm në kuptimin e dinjitetit dhe solemnitetit të procesit gjyqësor, por ajo ka sjellë probleme serioze edhe në kuptimin e sigurisë të jetës së gjyqtarëve dhe sigurimin fizik të të pandehurve. Gjithashtu infrastruktura ka ndikuar edhe në transparencën e proceseve gjyqësore duke qenë se përdorimi i sistemit audio mbetet i pjesshëm apo i pamundur. Ndër të tjera ajo ka sjellë dhe ngadalësim të ritmit të gjykimit në rastet kur sallat e gjyqit duhet të përdoren me grafik për shkak të numrit të tyre të kufizuar.
- **ngritjen e një sistemi të ri dhe unifikuar të menaxhimit të çështjeve gjyqësore**, si një nga investimet më të mëdha por më të domosdoshme për përmirësimin e të gjithë sistemit gjyqësor. Kjo është një iniciativë madhore, e cila kërkon angazhimin e KLGJ, ekzekutivit dhe partnerëve ndërkombëtarë duke mbajtur parasysh se krijimi i këtij sistemi kërkon një mbështetje financiare të qenësishme dhe ekspertizë të lartë teknike. Nga ana tjetër, nëse ky sistem ngrihet, ai vetë korrigjon disa probleme, sisteme të trashëguara: unifikon të dhënat e menaxhimit të çështjeve gjyqësore në të gjithë gjykatat (aktualisht ekzistojnë tre sisteme të ndryshme jo kompatibël me njëri-tjetrin); sjell evidentimin e saktë të volumit të çështjeve për gjyqtar dhe mundëson shpërndarjen e balancuar të ngarkesës së çështjeve; i jep fund ndërhyrjeve në sistem duke paracaktuar gjyqtarë për çështje konkrete si një burim i mundshëm korrupsioni; mat eficiencën e gjyqtarëve dhe gjeneron statistika të sakta, në kohë reale, duke mundësuar që KLGJ dhe aktorë të tjerë të interesuar të hartojnë politika të bazuara dhe vendimmarrje koherente në përgjigje të problemeve.
- **drejtimin e veprimtarisë institucionale të KLGJ-së dhe gjykatave në mënyrë të orientuar, koherente, të matshme dhe në përgjigje të nevojave**, kjo synohet të realizohet nëpërmjet procesit të Planifikimit Strategjik dhe hartimit të një Plani Veprimi për periudhën 2019-2020. Avancimi institucional në mënyrë të orientuar ndan një institucion të suksesshëm nga një më pak të suksesshëm për shkak se plani strategjik siguron jo vetëm planifikimin e masave, por dhe zbatimin e shënjestruar përkundrejt rezultateve të dëshiruara, si dhe ofron mundësinë për të matur avancimin në mënyrë cilësore dhe sasiore. Në të njëjtën kohë, nëpërmjet planit të veprimit, mundësohet një parashikim i rrugëtimit institucional i cili të lejon para shikueshmëri, provueshmëri, matje dhe korrigjim të masave, nëse del nevoja. KLGJ është një institucion ekzekutiv dhe administrues për të gjithë sistemin gjyqësor, ndaj Planifikimi Strategjik del si domosdoshmëri për të drejtuar jo vetëm veten por një sistem të tërë i cili pritet të vendosë standarde të reja.

Në përmbushje të të gjithë synimeve dhe përgjegjësisë të përcaktuara nga Kushtetuta në nenin 147, pika 1 dhe kuadrin ligjor të miratuar në funksion të Reformës në Drejtësi, Këshilli i Lartë Gjyqësor, me autoritetin e një organi qeverisës të sistemit gjyqësor, duke mbajtur parasysh dhe efektet e procesit të vettingut mbi eficiencën e punës në gjykata, menjëherë pas krijimit, ka ndërmarrë disa hapa të domosdoshëm për të adresuar me shpejtësi problemet më emergjente që u evidentuan pas periudhës së konstituimit të tij. Këto probleme dhe nisma do të raportohen në mënyrë më të detajuar në seksionet e

² Gjukata e Lartë, Gjukata e Apelit Tiranë, Gjukata e Rrethit Berat, Gjukata e Rrethit Durrës, Gjukata e Rrethit Fier, Gjukata e Rrethit Gjirokastër, Gjukata e Rrethit Kukës, Gjukata e Rrethit Përmet, Gjukata e Rrethit Shkodër, Gjukata e Rrethit Tropojë, Gjukata e Rrethit Tiranë, Gjukata Administrative e Shkallës së Parë Durrës, Gjukata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastër, Gjukata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë, Gjukata Administrative e Shkallës së Parë Korçë, Gjukata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër.

tjera të këtij raporti, por në terma të përgjithshëm mund të kategorizohen në tre shtylla kryesore:

- ngritjen e veprimtarisë organizative të vetë institucionit, duke miratuar aktet e nevojshme nënligjore që lidhen me mirëfunksionimin e tij, si ngritja e komisioneve të përhershme, e komisioneve të përkohshme për çështje të veçanta, miratimi i strukturës organizative të administratës së KLGJ;
- mbështetjen e procesit të vettingut duke kryer me përparësi vlerësimet profesionale të gjyqtareve;
- reagimin dhe veprimet imediate në përgjigje të vakancave dhe nevojave emergjente për mirëfunksionimin e gjykatave, si hartimi i rregullave për skemën e delegimit, transferimin e përkohshëm ashtu dhe të rregullave për caktimin e gjyqtarëve në gjykimin e çështjeve të veçanta në gjykata të tjera nga ku ushtron detyrën gjyqtari;
- nisjen e punës për krijimin e hartës gjyqësore dhe skemën e vlerësimit periodik të gjyqtarëve;
- hartimin e kritereve dhe rregulloreve për zgjedhjen e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë dhe gjykatave të posaçme për korrupsionin dhe krimin e organizuar.

1.2 PËRMBLEDHJE E PROBLEMATIKAVE KRYESORE QË ANALIZOHEN NË RAPORT

Si një analizë e sistemit gjyqësor për vitin 2018, raporti analizon situatën e funksionimit të sistemit gjyqësor gjatë periudhës kur autoriteti përgjegjës për mbikëqyrjen, administrimin dhe mbarëvajtjen e gjykatave (pa përfshirë Gjykatën e Lartë) ka qenë Këshilli i Lartë i Drejtësisë (KLD) si dhe periudhën e veprimtarisë pas ngritjes së Këshillit të Lartë Gjyqësor. Duhet të vihet në dukje se veprimtaria e KLD-së gjatë vitit 2018 ka qenë e pazakontë në kushtet e tej zgjatjes së ngritjes së institucionit zëvendësues të tij, Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ndonëse me ndryshimet Kushtetuese, neni 179, pika 5 dhe të legjislacionit në zbatim të tij, konkretisht në nenin 277 të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” ku parashikohej se Këshilli i Lartë i Drejtësisë duhet të ushtronte veprimtarinë e tij tranzitore deri në datën e ngritjes së Këshillit të Lartë Gjyqësor, ky i fundit nuk u ngrit brenda afatit 8 muaj nga hyrja në fuqi e ligjit, pra brenda datës 12 prill 2017. Në kushtet kur situata faktike u zgjat përtej parashikimeve ligjore, Këshilli i Lartë i Drejtësisë vijoi të ushtronte veprimtarinë e tij për rreth 19 muaj më shumë deri në ditën e mbledhjes së parë të Këshillit të Lartë Gjyqësor, më datë 20 dhjetor 2018.

Mos krijimi i KLGJ brenda afateve të përcaktuara ka krijuar problematikë në

- funksionimin e sistemit të drejtësisë në tërësi;
- në garantimin e të drejtave statutores të gjyqtarëve;
- në mirë administrimin e gjykatave dhe për pasojë dhe në shërbimin ndaj qytetarëve.

Përgjatë kësaj periudhe, me mosfunksionimin e KLGJ-së, por të KLD-së për një periudhë më shumë se 19 muaj nga parashikimi kushtetues, kompetencat e cunguara nuk garantohen pavarësinë, përgjegjshmërinë dhe eficientësinë e duhur për sistemin gjyqësor. Në lidhje me statusin e gjyqtarëve, për një kohë të gjatë, u krijua pasiguri dhe paqartësi:

- në procesin e emërimit të magjistratëve të rinj;

- në dhënien e lejeve për ushtrimin e veprimtarive akademike apo të lejeve të tjera;
- në garantimin e një procesi të rregullt ligjor në funksion të procedimit disiplinor për shkak të shfuqizimit të listës së shkeljeve disiplinore nga Gjykata Kushtetuese me vendimin e saj nr. 34, datë 10.04.2017;
- në mos vijueshmërinë e procesit të vlerësimit profesional të gjyqtarëve por duke u fokusuar vetëm në procesin e rivlerësimit kalimtar të tyre;

Në lidhje me administrimin e gjykatave, u evidentua pamundësi:

- për caktimin e gjyqtarëve në funksionet drejtuese të gjykatave, në rastet kur kishte dorëheqje nga ushtrimi i detyrës, apo në rastet e shkarkimit nga detyra nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit;
- për pasojë u krijua paqartësi në administratën gjyqësore, në kushtet kur KLGJ dhe Këshillat e gjykatave nuk ishin ngritur ende.

Më poshtë parashtrohen në mënyrë më shteruese një pjesë e problematikave që u gjeneruan edhe si pjesë e kompetencave të kufizuara të KLD-së së kohës, por që erdhën si barrë e shtuar duke përkeqësuar edhe me shumë situatën e sistemit gjyqësor që do të trashëgonte institucioni pasardhës, KLGJ-ja.

- Sipas parashikimeve të pjesës V dhe dispozitave kalimtare të ligjit nr.96/2016, Inspektorati i KLD ishte struktura kompetente për të hetuar shkeljet disiplinore të të gjithë gjyqtarëve dhe inspektorëve, deri në krijimin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë (ILD). Në kushtet kur ky institucion nuk është ngritur ende dhe një numër ankesash ndaj veprimtarisë së gjyqtarëve edhe pse janë shqyrtuar nga Inspektorati nuk kanë marrë zgjidhje nga ish-KLD, këto praktika u depozituan në KLGJ. Duke qenë se sipas ligjit ILD është institucioni kompetent dhe jo KLGJ, Këshillit i del detyra t'i përcjellë këto praktika për vlerësimin e mëtejshëm të ILD, apo si indice në rastet kur afati ligjor për shqyrtimin e tyre ka përfunduar.
- Neni 171, pika 1 e ligjit nr.96/2016, parashikon se KLD duhet të përfundonte vlerësimin e gjyqtarëve të shkallës së parë dhe të apelit për periudhën 2007-2012, bazuar në rregullat ekzistuese para hyrjes në fuqi të këtij ligji. Procesi i vlerësimit të gjyqtarëve mbeti vetëm në fazën fillestare. Aktualisht ka përfunduar vlerësimi vetëm për periudhën 2007–2009, ndërkohë që nga kjo periudhë e deri më sot kanë hyrë në sistem breza të tërë magjistratësh, të cilët nuk kanë asnjë vlerësim profesional të veprimtarisë së tyre. Kjo situatë mund të përbëjë pengesë për këto magjistratë në kushtet kur ato mund të kenë pretendimin legjitim të promovohen në instanca më të larta, në të njëjtën kohë mungesa e vlerësimit nuk lejon një tablo të qartë për vlerësimin e profesionalizmit në aplikimin e detyrës së tyre. Aktualisht në sistem janë rreth 62 gjyqtarë të cilët nuk kanë asnjë vlerësim profesional të veprimtarisë së tyre si gjyqtar.
- Gjatë veprimtarisë së KLD ka pasur vende vakante të krijuara në gjykata. Këto vakanca nuk i përkasin vetëm vitit 2018 por janë mbartur edhe nga vitet e mëparshme. Ky problem krijon vështirësi në çdo gjykatë që ekziston por mund të krijojë kolaps në gjykatat e vogla me 4-5 gjyqtarë. Nëse kjo situatë shihet edhe nën dritën e efekteve të procesit të vettingut ajo mund të përbëjë një problem real për mosfunksionimin e gjykatave në rrethe të caktuara. Ndaj, vëmendja dhe reagimi i KLGJ me masa të përkohshme është i menjëhershëm.

Ndërkohë, Këshilli Lartë Gjyqësor që në fillimet e veprimtarisë së tij u përball me problematika të mbartura. Menjëherë pas zhvillimit të mbledhjes së parë u desh të trajtonte me zgjidhje probleme akute për sistemin, si:

- vakumi që u krijua në drejtimin e disa gjykatave si pasojë e shkarkimit të kryetarëve të gjykatave gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar konkretisht në gjykatat e rretheve gjyqësore Pukë, Berat dhe Korçë. Në këtë drejtim KLGJ i hapi rrugën zgjedhjes së zëvendëskryetarëve të gjykatave duke miratuar rregulloren përkatëse. Zgjedhja e zëvendëskryetarëve plotëson vakumin që krijohet në rast të mungesës së kryetarit, pasi ligji parashikon që në mungesë të kryetarit, ushtron detyrat zëvendëskryetari.
- nisja e procesit për caktimin e përkohshëm të gjyqtarëve pranë Gjykatave të Posaçme për Gjykimin e Veprave Penale të Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar;
- nisja e procesit të emërimit dhe caktimi në detyrë i magjistratëve të cilët përfunduan Shkollën e Magjistraturës në vitin 2018;
- ngritja e strukturës përgjegjëse për bashkëpunimin e nevojshëm me institucionet e rivlerësimit kalimtar për te evituar pengimin e procesit;
- trajtimi i një stoku me kërkesa të gjetura (184 kërkesa), të ardhura nga gjykatat ku kërkohej delegimi i gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve të caktuara;
- zhbllokimi i situatës për Shkollën e Magjistraturës nëpërmjet miratimit të kuotave për 25 kandidatë për magjistratë dhe 25 kandidatë për ndihmës ligjorë;
- vlerësimi i situatës dhe ngritja e Komisionit të Përkohshëm për Shqyrtimin e Ankimeve Kundër vendimeve të Kryeinspektorit të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë për Arkivimin e Ankesës ose Pushimin e Hetimit ndaj një Gjyqtari, detyrim ky i parashikuar nga ligji për KLGJ-në, në nenin 62, pika 13 e ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”;
- ngritja e komisioneve të përhershme sipas parashikimeve ligjore, ashtu edhe komisioneve të posaçme si një domosdoshmëri për të shqyrtuar çështje të veçanta. Konkretisht, Komisionet e Përkohshme për (i) Vlerësimin etik dhe profesional në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve; (ii) Verifikimin e plotësimit të kriterëve të kandidatëve për këshilltarë dhe ndihmës ligjorë, që do të pranohen për të ndjekur programin e Formimit Fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, viti akademik 2019-2020; (iii) Shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Kryeinspektorit të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë për arkivimin e ankesës ose pushimin e hetimit ndaj një gjyqtari; si dhe, (iv) Vlerësimin e statusit individual dhe karriera e inspektorëve të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë.
- përballja me ankesat e reja të ardhura në drejtim të KLGJ-së, ankesa të cilat janë ndaj veprimtarisë së gjyqtarëve, në kushtet kur një kompetencë e tillë nuk është e KLGJ-së por e një institucioni tjetër që ende nuk është krijuar, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.
- hartimi dhe miratimi i akteve nënligjore si caktimi i përkohshëm në detyrë i të emëruarve të rinj në pozicione të komanduara, rregullat për ngritjen në detyrë në nivele më të larta ose të specializuara të gjyqtarëve, rregullat për emërimin e anëtarëve jo gjyqtarë të Gjykatës së Lartë, etj.

Raporti vjetor i Këshillit të Lartë Gjyqësor paraqitet në përmbushje të detyrimit ligjor parashikuar në nenin 82, të ligjit nr.115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”. Me Urdhrin Nr.129 datë 01.04.2019 u ngrit grupi i punës për hartimin e projekt-raportit mbi gjendjen e sistemit gjyqësor për vitin 2018. Këshilli i Lartë Gjyqësor përmes këtij raporti, bën të njohur punën dhe masat e ndërmarra menjëherë

pas konstituimit të tij, prezantimin e arritjeve të deritanishme duke mbajtur në konsideratë kohën e shkurtër nga momenti i ngritjes së institucionit dhe momentin e raportimit. Duke qenë se gjatë vitit 2018 një pjesë e veprimtarisë i përket institucionit pararendës, Këshillit të Lartë të Drejtësisë i cili nuk ekziston më që nga krijimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor, aktiviteti gjatë kësaj periudhe është përfshirë në këtë raport për efekt të detyrimit të raportimit si dhe për të evidentuar situatën e trashëguar në sistemin gjyqësor. Ndërsa në kuptimin e përgjegjësive, punës konkrete dhe synimeve strategjike ky raport do të fokusohet në veprimtarinë e cila është kompetencë e Këshillit të Lartë Gjyqësor, duke theksuar tablonë faktike e cila raportohet në statistika nga gjykatat e vendit, analizën e problemeve akute të cilat do të kërkojnë angazhimin e KLGJ-së gjatë vitit pasues, duke mbajtur në konsideratë rekomandimet konkrete në nivel masash si nga ana e vetë KLGJ-së, por dhe duke parashtruar fushat ku mbështetja e Kuvendit të Shqipërisë do të sillte një ndryshim të prekshëm.

1.3 KUADRI LIGJOR: FUSHËVEPRIMI, KOMPETENCAT DHE PRITSHMËRIA NDAJ KLGJ-SË

Ligji më i rëndësishëm që startoi të gjithë procesin e Reformës në Drejtësi është ligji nr.76/2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, e ndryshuar, që hyri në fuqi në datën 12 gusht 2016. Menjëherë pas miratimit të këtij ligji themelor, u konkludua me miratimin e një pakete të tërë ligjesh në stadin e parë të zbatimit të ndryshimeve kushtetuese dhe të implementimit të Reformës në Drejtësi. Konkretisht Kushtetuta në nenin 147, pika a³ por dhe në ligjin nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, në ligjin nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ka dhënë KLGJ-së autoritetin e një organi qeverisës të sistemit gjyqësor.

KLJGJ do të synojë, të krijojë një sistem gjyqësor:

- ✓ të pavarur dhe të paanshëm në ushtrimin e përgjegjësive të tij;
- ✓ të përgjegjshëm, llogaridhënës, me integritet të lartë moral dhe profesional në të gjitha nivelet strukturore të tij;
- ✓ eficient dhe profesional;
- ✓ transparent dhe të besueshëm prej publikut.

Ndaj për të realizuar këto objektiva, kërkohet një fokusim i punës në disa aspekte:

(i) ngritja e një strukture organizative e cila të garantojë mirëqeverisjen e sistemit, si dhe veprimtarinë e KLGJ-së (funksionimi i komisioneve, i ngritjes së një administrate e cila të reflektojë dhe t'i përgjigjet detyrave dhe përgjegjësive të çdo fushe që ky institucioni ka);

3 Neni 147/a i Kushtetutës: a) emëron, vlerëson, ngre në detyrë dhe transferon gjyqtarët e të gjitha niveleve; b) vendos për masat disiplinore ndaj gjyqtarëve të të gjitha niveleve; c) i propozon Presidentit të Republikës kandidatët për gjyqtarë të Gjykatës së Lartë, sipas ligjit; ç) miraton rregullat e etikës gjyqësore dhe mbikëqyr respektimin e tyre; d) drejton dhe kujdeset për mbarëvajtjen e punës në administratën e gjykatave, me përjashtim të mbarëvajtjes së strukturave të teknologjisë së informacionit në gjykata, e cila rregullohet me vendim të Këshillit të Ministrave; dh) propozon dhe administron buxhetin e tij dhe të gjykatave; e) informon publikun dhe Kuvendin për gjendjen e sistemit gjyqësor; ë) ushtron funksione të tjera të caktuara me ligj.

(ii) **hartimi i një pakete të tërë aktesh nënligjore të domosdoshme** të cilat janë jo vetëm një detyrim që buron nga ligji dhe Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë, por janë të domosdoshme për përmbushjen e përgjegjësisë institucionale. Fillimisht duke miratuar aktet që lidhen me aktivitete jashtë funksionit, krijimin e dosjeve personale të magjistratëve, caktimin e përkohshëm në detyrë të të emëruarve të rinj në pozicione të komanduara, caktimin e magjistratëve në skemën e delegimit, ngritjen në detyrë të gjyqtarëve në nivele më të larta ose të specializuara, emërimin e anëtarëve jo gjyqtarë të Gjykatës së Lartë, etj. Është e nevojshme të mbahet parasysh që problematikat që dalin nga zbatimi të reflektohen duke përmirësuar aktin;

(iii) **vlerësimi i situatës aktuale, të organizimit të rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave me qëllim realizimin e një harte të re gjyqësore**, për të siguruar garantimin e aksesit në drejtësi, uljen e kostove duke përdorur me efektshmëri burimet publike, rritjen e cilësisë dhe përshtatshmërisë së shërbimeve të ofruara, me qëllim rritjen e efikasitetit dhe për të siguruar specializimin në gjykata.

(iv) **përcaktimi i kritereve dhe krijimi i rregullave të reja për zgjedhjen e këshillit të gjykatave, kryetarëve dhe kancelarëve.**

(v) **ngritja e një strukture organizative të administratës gjyqësore me detyra të mirë përcaktuara, me këshilltarët, ndihmësit ligjorë dhe nëpunësit e tjerë të administratës;**

(vi) **përmirësimi i anës financiare të buxheteve të gjykatave dhe krijimi i kushteve të domosdoshme infrastrukture.**

2 RAPORT MBI VEPRIMTARINË E ISH-KLD-SË

Ndryshimet kushtetuese të vitit 2016 nuk parashikuan rregulla të veçanta për kompetencat tranzitore të ish-KLD-së. Ky parashikim gjeti rregullim në ligjin nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, konkretisht në nenin 160, pika 1 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve” e në vijim. Sipas këtij neni, ish-KLD-ja si organ kompetent për periudhën kalimtare, deri në krijimin e KLGJ-së dhe ILD-së, do ushtronte kompetenca të tilla si emërimin e magjistratëve kandidatë të diplomuar në vitin 2016; marrjen e vendimeve për caktimin në pozicion të kandidatëve magjistratë të diplomuar në vitin 2016; vendosjen e masave disiplinore, me propozim të Ministrit të Drejtësisë; pezullimin e gjyqtarëve sipas kërkesave të ligjit; vlerësimin e punës së gjyqtarëve si dhe ndihmën në procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve; vendosjen e masave disiplinore për inspektorët; vërtetimin e ndërprerjes së emërimit të gjyqtarëve në rast dorëheqje apo mbushjes së moshës së pensionit si dhe transferimin përkohësisht të gjyqtarëve për plotësimin e trupave gjyqësore.

2.1 VEPRIMTARIA E INSPEKTORATIT (IKLD)

Veprimtaria e Inspektoratit - Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë (IKLD) ka qenë një strukturë shtetërore, e ngritur me ligj në vitin 1999, dhe funksiononte në varësi të drejtpërdrejtë të ish-KLD-së. Me ligj, ish-IKLD-së i ishte ngarkuar përgjegjësia e monitorimit të performancës së sistemit gjyqësor nëpërmjet ushtrimit të inspektimeve, verifikimit të ankesave dhe vlerësimit të aftësive profesionale të gjyqtarëve. Veprimtaria e ish-IKLD-së i ka shërbyer ish-KLD-së për të ushtruar funksionet kushtetuese të kontrollit dhe të rritjes në karrierë të gjyqtarëve. Organizimi dhe funksionimi i tij rregullohej përmes dy ligjeve organike mbi pushtetin gjyqësor dhe mbi ish-KLD-në.

Gjatë periudhës së ushtrimit të veprimtarisë së saj në vitin 2018 ish-KLD ka zhvilluar gjithsej 9⁴ mbledhje plenare, nga të cilat, dy janë të jashtëzakonshme. Në rendet e ditës së këtyre mbledhjeve janë përfshirë për t’u trajtuar 60 çështje dhe janë marrë 54 vendime. Më poshtë evidentojmë në mënyrë të përmbledhur çështjet të cilat janë shqyrtuar duke filluar me:

Shqyrtimi i kërkesave të Ministrit të Drejtësisë për procedimin disiplinor të gjyqtarëve, si dhe procedimi disiplinor i inspektorëve – Në nenin 160 të ligjit nr.96/2016 parashikohet se: *“Deri në krijimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe inspektoratet ekzistuese do të vazhdojnë të ushtrojnë kompetencat e mëposhtme, sipas rregullave të parashikuara në këtë ligj: a)...c) vendos masa disiplinore, me propozim të Ministrit të Drejtësisë, bazuar në procedurën dhe kriteret që parashikohen në pjesën V, kreu I, të këtij ligji;...e) vendos masa disiplinore për inspektorët, bazuar në aktet nënligjore në fuqi”.*

Bazuar në këtë kuadër ligjor janë shqyrtuar kërkesat e ardhura përgjatë vitit 2017 dhe vitit 2018 nga Ministri i Drejtësisë për procedim disiplinor ndaj gjyqtarëve, dhe konkretisht janë marrë në shqyrtim dhe kanë përfunduar 16 procedime disiplinore për 16 gjyqtarë, me rezultatet e mëposhtme:

⁴ Mbledhje në datat 18.01.2018, 24.01.2018, 09.02.2018, 07.05.2018, 12.06.2018, 13.06.2018, 29.06.2018, 11.10.2018 dhe 19.11.2018, si dhe ka marrë një vendim qarkullues (nr.28 datë 18.04.2018).

- 12 gjyqtarë rrëzohet⁵ kërkesa e MD dhe nuk propozohet masë tjetër;
- 3 gjyqtarë “Vërejtje publike”⁶;
- 1 gjyqtar “Vërejtje konfidenciale”⁷.

Duhet evidentuar problematika që shfaqet në procesin e procedimit disiplinor ndaj gjyqtarëve si pasojë e situatës së krijuar pas vendimit, për shfuqizim nga Gjykata Kushtetuese⁸ të neneve 101-104 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të cilat përmbajnë rregulla mbi përgjegjësinë disiplinore, civile dhe penale të magistratëve, duke rregulluar konkretisht shkeljet disiplinore dhe çështje të veprimtarisë, shkeljet disiplinore në lidhje me ushtrimin e funksionit, shkeljet disiplinore jashtë ushtrimit të funksionit dhe shkeljet disiplinore për shkak të kryerjes së veprës penale.

Shqyrtimi i ankesave të ardhura të cilat mund të paraqiteshin nga qytetarët ose çdo subjekt i interesuar pranë ish-KLD, ka qenë një nga përgjegjësitë më të rëndësishme të Inspektoratit pranë ish-KLD-së. Ky proces është zhvilluar bazuar në nenet 126-147 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Sa më lart, përgjatë periudhës **01.01.2018 - 31.12.2018**, **numri i ankesave të paraqitura është 772**, nga të cilat 736 ankesa janë paraqitur nëpërmjet shërbimit postar apo fizikisht nga ankuesit, 36 ankesa janë paraqitur në sistemin online të ankesave dhe nëpërmjet postës elektronike.

Pas shqyrtimit paraprak të 772 ankesave të paraqitura, **272 prej tyre janë arkivuar (35.2%)** pas shqyrtimit fillestar me arsyetimin se pretendimet zgjidhen përmes apelimit gjyqësor apo janë ankesa të përsëritura më parë (bazuar në Nenin 120 të ligjit nr.96/2016 cituar më lart), **ndërsa për 500 ankesa të tjera situata është si më poshtë:**

- **për 9 ankesa është sugjeruar hetim disiplinor** mbas verifikimit shtesë;
- **për 132 ankesa është sugjeruar verifikim shtesë**, mbas shqyrtimit paraprak;
- **pjesa e mbetur prej 359 ankesa janë në proces shqyrtimi fillestar** nga ana e Inspektoratit. Ky proces, bazuar në nenin 194 të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” do të kryhet nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, në momentin e krijimit të tij, pasi ky i fundit është organi që ka kompetencën për verifikimin e ankesave.

⁵ Vendimi nr. 6, datë 24.01.2018, rrëzimi i kërkesës për “Shkarkim nga detyra” ndaj gjyqtarit A.K.;
 Vendimi nr. 7, datë 24.01.2018, rrëzimi i kërkesës për “Shkarkim nga detyra” ndaj gjyqtarit Sh.P.;
 Vendimi nr. 9, datë 24.01.2018, rrëzimi i kërkesës për masën disiplinore “Shkarkim nga detyra” të gjyqtarit A.Sh.;
 Vendimi nr. 12, datë 24.01.2018, rrëzimi i kërkesës për “Shkarkim nga detyra” ndaj gjyqtarit M.Ll.;
 Vendimi nr. 13, datë 24.01.2018, rrëzimi i kërkesës për “Vërejtje me paralajmërim” ndaj gjyqtarit G.Xh.;
 Vendimi nr. 14, datë 24.01.2018, rrëzimi i kërkesës për “Vërejtje me paralajmërim”, ashtu si edhe kërkesa e dytë për masë disiplinore “Vërejtje konfidenciale” ndaj gjyqtarit A.K.;
 Vendimi nr. 15, datë 24.01.2018, rrëzimi i kërkesës për “Shkarkim nga detyra” ndaj gjyqtarit E.D.;
 Vendimi nr. 16, datë 24.01.2018, rrëzimi i kërkesës për masën disiplinore “Shkarkim nga detyra” ndaj gjyqtarit R.D.;
 Vendimi nr. 40, datë 07.05.2018, rrëzimi i kërkesës për “Vërejtje me paralajmërim” ndaj gjyqtarit L.F.;
 Vendimi nr. 41, datë 07.05.2018, rrëzimi i kërkesës për “Shkarkim nga detyra” ndaj gjyqtarit P.Ç.;
 Vendimi nr. 43, datë 07.05.2018, rrëzimi i kërkesës për “Shkarkim nga detyra” ndaj gjyqtarit K.Dh.;
 Vendimi nr. 44, datë 12.06.2018, rrëzimi i kërkesës për “Shkarkim nga detyra” ndaj gjyqtarit A.J.;
⁶Vendimi nr. 8, datë 24.01.2018, është vendosur masa disiplinore “Vërejtje publike” ndaj gjyqtarit Dh.B.;
 Vendimi nr. 11, datë 24.01.2018, është vendosur masa disiplinore “Vërejtje publike” ndaj gjyqtarit T.K.;
 Vendimi nr. 42, datë 07.05.2018, është vendosur masa disiplinore “Vërejtje publike” ndaj gjyqtarit E.S.;
⁷Vendimi nr. 10, datë 24.01.2018, është vendosur masa disiplinore “Vërejtje konfidenciale”;

⁸ Vendimi nr.34 datë 10.04.2017

2.2 VLERËSIMI I VEPRIMTARISË PROFESIONALE DHE ETIKE TË GJYQTARËVE

Lidhur me vlerësimin e veprimtarisë gjyqësore dhe etike të gjyqtarëve të shkallës së parë dhe të apelit, duhet theksuar se ka qenë një ndër përgjegjësitë⁹ kryesore të ish-KLD-së, kjo bazuar në nenin 16, pika 1, shkronja 'dh' të ligjit nr.8811/2001 "Për organizimin dhe funksionimin e KLD-së", i ndryshuar, si dhe nenin 13 i ligjit nr.9877/2008 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. Finalizimi i vlerësimit të gjyqtarëve dhe krijimi i një tradite institucionale të këtij procesi ka qenë një prej dy prioriteteve kryesore të ish-KLD-së, i përcaktuar nga ish-KLD për shkak të lidhjes së tij të drejtpërdrejtë me sistemin e karrierës së gjyqtarëve. Nga dokumentacioni që ndodhet pranë institucionit, konstatohet se ka përfunduar vlerësimi profesional dhe etik vetëm për 2 gjyqtarë gjatë viti 2018.

2.3 PEZULLIME TË GJYQTARËVE NGA DETYRA

Në lidhje me pezullimin e gjyqtarëve, me bazë ligjore në nenin 140, pika 3¹⁰ të Kushtetutës, tashmë parashikohen tre raste të pezullimit nga detyra të gjyqtarëve, dy prej të cilave lidhen me ushtrimin e ndjekjes penale ndaj gjyqtarit, ndërsa rasti i tretë lidhet me fillimin e procedimit disiplinor. Nisur nga kjo kompetencë tranzitore, ish-KLD ka pezulluar nga ushtrimi i detyrës 3 gjyqtarë, gjyqtarë pranë Gjykatës së Apelit Durrës në mbledhjen e tij të datës 09.02.2018¹¹, bazuar në informacionin e ardhur nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda e cila i kishte marrë si të pandehur të tre gjyqtarët.

2.4 VLERËSIMI PROFESIONAL I GJYQTARËVE NË KUADËR TË PROCESIT TË RIVLERËSIMIT KALIMTAR

Vlerësimi profesional i gjyqtarëve në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar ka qenë fokusi tjetër i zhvillimit të veprimtarisë së ish-KLD-së gjatë vitit 2018, duke dhënë ndihmë për hartimin e raportit të analizimit të aftësive profesionale në kuadër të procesit të rivlerësimit. Ligji nr.84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" (Ligji "Për rivlerësimin") përcakton si një prej komponentëve të rivlerësimit – vlerësimin profesional të subjekteve të rivlerësimit, duke ngarkuar, bazuar në nenin 171, pika 2 të ligjit nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", ish-KLD-në dhe Inspektoratin e tij, me disa detyra specifike, në rolin e organit ndihmës të organeve të rivlerësimit – Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe Kolegjit të Apelit.

Si e tillë, gjatë vitit 2018 (deri më datë 19.12.2018) nga ana e ish-KLD-së janë organizuar **140 shorte** për përzgjedhjen e 5 dosjeve për 140 subjekte të rivlerësimit kalimtar. Pas organizimit të shorteve për përzgjedhjen e dosjeve të shqyrtuara nga subjektet e rivlerësimit, Inspektorati pranë ish-KLD-së ka kërkuar gjithsej **700 dosje** gjyqësore/dokumente ligjore, në gjykatat respektive ku administrohen këto akte, secila

⁹ Neni 16 i Ligjit Nr. 8811/2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë"

¹⁰ "Neni 140 - 3. Gjyqtari pezullohet nga detyra me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor kur: a) ndaj tij caktohet masa e sigurimit personal "arrest në burg" ose "arrest në shtëpi" për kryerjen e një veprë penale; b) ai merr cilësinë e të pandehurit për një krim të rëndë të kryer me dashje; c) kur fillon procedimi disiplinor, sipas ligjit".

¹¹ Vendimet nr. 22, nr. 23 dhe nr. 24, datë 09.02.2018

prej tyre në 2 kopje (një kopje për KPK-në dhe një kopje për ONM-në). Në shtesë të shorteve të plota të përshkruara më sipër, nga ana e Inspektoratit pranë ish-KLD-së është organizuar shorti për **12 subjekte** të tjera rivlerësimi, por këto shorte janë organizuar në mënyrë të pjesshme (për shkak të ushtrimit të veprimtarisë nga subjekti në më shumë se 1 gjykatë.

Ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë ka proceduar me depozitimin e raporteve dhe të dosjeve gjyqësore pranë KPK-së me grupe subjektësh rivlerësimi, në varësi të institucionit. Sipas kësaj qasjeje, deri më datë 19.12.2018 janë depozituar pranë KPK-së gjithsej **111 raporte** të hollësishme dhe të arsyetuara, të shoqëruara me 550 dosje gjyqësore për 111 subjekte rivlerësimi.

2.5 TRANSFERIME TË GJYQTARËVE

Lidhur me transferimet e gjyqtarëve, ligji nr.96.2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” lejonte ish-KLD-në, që deri në krijimin e KLGJ-së, të transferojë përkohësisht gjyqtarë në gjykata. Konkretisht në nenin 160, pika 1, germa ‘f’ të ligjit nr.96/2016 theksohej se “*f) transferon përkohësisht gjyqtarë për plotësimin e trupave gjyqësorë në gjykata*”.

Në referim të kësaj kompetence dhe të situatës në gjykata me numër të vogël të gjyqtarëve, ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë, me vendimin nr.47, datë 13.06.2019 bëri transferimin e përkohshëm për 1 vit, të disa gjyqtarëve në disa gjykata, e konkretisht: 2 gjyqtarë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës, 2 gjyqtarë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë, 1 gjyqtar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës dhe 1 gjyqtar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër.

Analiza mbi transferimin e përkohshëm për një periudhë kohe të gjyqtarëve pranë gjykatave me numër të vogël të gjyqtarëve, 2 gjyqtarë, u krye duke mbajtur në konsideratë (i) pasqyrimin statistikor mbi numrin e gjyqtarëve faktik në çdo gjykatë, e shoqëruar kjo edhe me ngarkesën e çështjeve të regjistruara për gjykim pranë këtyre gjykatave; (ii) përlllogaritjet e ngarkesës mesatare të gjyqtarëve sipas gjykatave me ngarkesë të ulët (iii) procedurën ligjore që duhet për të kryer transferimin e përkohshëm të gjyqtarëve.

2.6 KËRKESAT PËR DELEGIME TË GJYQTARËVE NË GJYKATA TË TJERA

Në lidhje me delegimin e gjyqtarëve pranë gjykatave, ky i fundit ka qenë një proces i cili realizohej bazuar në kërkesat e ardhura nga gjykatat në të cilat kërkohej delegimi i gjyqtarëve, në shqyrtimin e çështjeve të caktuara gjyqësore. Inspektorati ishte ngarkuar me përpunimin e të gjitha kërkesave, duke përgatitur relacione të detajuara dhe tabelat për çdo çështje apo grup çështjesh që i përkasin të njëjtës gjykatë, me qëllim propozimin ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë, për gjyqtarin/ët konkretë të gjykatës nga ku do të kryhet delegimi në zbatim të kritereve të delegimit.

Në ushtrim të kësaj veprimtarie, gjatë vitit 2018 janë depozituar në ish-Këshillin e Lartë të Drejtësisë **gjithsej 632 kërkesa** nga kryetarët respektivë të gjykatave për delegimin e **896 gjyqtarëve në 632 çështje**, me motivacionin se nuk kanë mundësi të shqyrtojnë një apo disa çështje brenda afateve të arsyeshme kohore.

Nga gjykatat e apeleve janë paraqitur gjithsej 217 kërkesa (127 kërkesa për delegime për çështjet penale dhe 90 për çështjet civile), për delegimin e 397 gjyqtarëve në 217 çështje gjithsej, ndërkohë nga Gjykatat e Shkallës së Parë janë paraqitur 415 kërkesa (272 kërkesa për delegime për çështjet penale dhe 143 për çështjet civile).

Analiza e këtyre të dhënave konstaton: (i) numrin e lartë të kërkesave të paraqitura për delegim e cila përkthehet në kosto financiare të procesit gjyqësor nga njëra anë, por edhe zgjat kohën e gjykimit në dëm të palëve nga ana tjetër; (ii) numri i kërkesave është më i lartë në gjykatat e shkallës së parë se sa në gjykatat e shkallës së dytë dhe një monitorim i kujdesshëm duhet të nxjerrë në pah eficiencën e organizimit gjyqësor. Në kontekstin e monitorimit të këtij procesi, duhet evidentuar se faktorët që kanë ndikuar ndjeshëm në numrin e lartë të kërkesave për delegime janë: (i) numri i lartë i heqjeve dorë apo përjashtimeve të gjyqtarëve nga procese konkrete; (ii) mungesat në organikën e gjykatave, ku vlen të evidentohet fakti se këto mungesa kanë ardhur edhe për shkak të mos kalimit me sukses të procesit të rivlerësimit kalimtar nga gjyqtarët.

Informacionet periodike të ardhura nga kryetarët e gjykatave, në lidhje me problematikat e konstatuara në gjykatat e tyre, ka qenë një procedurë që ndiqej rregullisht. Nisur nga reklamimi i këtij informacioni, bazuar në nenin 122 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në RSH”, procedohej me verifikimin e raportimeve të reja të rasteve të vonesave, duke kërkuar të dhëna shtesë për arsyet e vonesës (nëse ka patur shkaqe shëndetësore apo ndonjë shkak tjetër të arsyeshëm), për të vlerësuar më pas nëse ka vend për hetimin disiplinor të veprimtarisë së ndonjë gjyqtari.

Ky mekanizëm raportimi i kryetarëve vlerësohet të jetë një mjet i mirë për monitorimin e veprimtarisë së gjyqtarëve dhe të gjykatave, por që duhet të kryhet në një formë më të standardizuar, për të krijuar lehtësi për përpunimin e tij.

Lidhur me këtë situatë edhe KLGJ në mbledhjen e tij të datës 07.02.2019, me vendimin nr. 25¹² ka vendosur të kërkojë informacion periodik¹³ nga gjykatat lidhur me ngarkesë e çështjeve gjyqësore për gjykatën dhe çdo gjyqtar të saj; respektimin e etikës dhe solemnitetit; numrin e kërkesave për heqje dorë të miratuara nga kryetari i gjykatës për çdo gjyqtar; funksionimin e sistemit të regjistrimit audio; gjendjen e përdorimit dhe funksionimit të sistemit të menaxhimit të çështjeve; problematika të shfaqura në lidhje me vonesat në dorëzimin e vendimeve të arsyetuara, ashtu si dhe çdo problematikë tjetër të evidentuar. Ky informacion do të shërbejë për të pasur në kohë dhe për të studiuar dhe analizuar, dhe për të parë mundësinë, nëse është e nevojshme, të reflektohen në akte të ndryshme nënligjore.

¹² Vendimi nr. 25, datë 07.02.2019 “Mbi informacionin periodik të kryetarëve të gjykatave në lidhje me veprimtarinë gjyqësore”

¹³ a) Ngarkesën e çështjeve gjyqësore për gjykatën dhe çdo gjyqtar të saj, evidentimin e numrit të çështjeve të mbartura nga vitet paraardhëse, si dhe numrin e çështjeve të zvarritura tej afateve të arsyeshme b) Respektimin e etikës dhe solemnitetit nga ana e trupës gjyqësore. c) Numrin e kërkesave për heqje dorë të miratuara nga kryetari i gjykatës për çdo gjyqtar si dhe të vendimeve për përjashtim gjyqtari të pranuar me kërkesë të palëve për shkak të konfliktit të interesit, bashkë me emrin e gjyqtarit të përjashtuar. c) Funksionimin e sistemit të regjistrimit audio dhe nivelin e përdorimit të tij nga secili gjyqtar. Paraqitjen në përqindje të numrit të seancave gjyqësore që regjistrohen në sistemin audio dhe shkaqeve për të cilat procesverbalet mbahen me mjete të tjera (kompjuter apo dorëshkrim). Evidentimin në përqindje të seancave gjyqësore të filluara me vonesë nga secili gjyqtar. d) Gjendjen e përdorimit dhe funksionimit të sistemit të menaxhimit të çështjeve, së bashku me nevojat e konstatuara për përditësimin e këtij sistemi. e) Problematika të shfaqura në lidhje me vonesat në dorëzimin e vendimeve të arsyetuara. f) Çdo problematikë tjetër të evidentuar.

2.7 PËRMBLEDHJE MBI VEPRIMTARINË E ISH-KLD-SË

Në përfundim: vlerësojmë se kohëzgjatja e fushëveprimit të dispozitave tranzitore me të cilat ish-KLD ka vepruar ka krijuar një situatë pasigurie në aspektin e zhvillimeve të ecurisë së reformës në drejtësi. Disa nga problematikat kryesore që u krijuan gjatë kësaj periudhe përfshijnë:

- mos emërimi në kohë i magistratëve të rinj ka passjellë efekte serioze financiare për KLGJ-në për një shumë prej për afërsisht 14 milion lekë të reja pasi 10 magistratë kanë fituar gjyqet kundër ish-ZABGJ-së tashmë pjesë e strukturës së KLGJ-së.
- mos shqyrtimi i kërkesave të gjyqtarëve për ushtrim të veprimitarisë akademike;
- vakumi që krijohet në gjykata në rastet e shkarkimit të gjyqtarëve nga institucionet e rivlerësimit kur gjyqtari njëkohësisht ushtronte detyrën e Kryetarit të Gjykatës;
- shfuqizimi nga Gjykata Kushtetuese i neneve 101-104 të ligjit nr.96/2016 mbi listën e shkeljeve disiplinore dhe vonesa në krijimin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;
- mos përfundimi i vlerësimit të gjyqtarëve për periudhën 2010-2012 duke krijuar mungesë informacioni dhe bazë vlerësimi për promovimin e magistratëve për vite të tëra.

3 RAPORTIM MBI VEPRIMTARINË E KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

Neni 147 i Kushtetutës e ka parashikuar Këshillin e Lartë Gjyqësor si një organ kolegjal të përbërë nga 11 anëtarë, nga të cilët 6 anëtarë zgjidhen nga radhët e gjyqtarëve të të gjitha niveleve të sistemit gjyqësor dhe 5 anëtarë zgjidhen nga Kuvendi midis radhëve të juristëve.

Këshilli i Lartë Gjyqësor zhvilloi mbledhjen e tij të parë më datë 20.12.2018. Në mbledhje morën pjesë 11 anëtarë¹⁴. Mbështetur në autoritetin që i buron nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe parashikimet e nenit 277, pika 3, të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, me besimin dhe angazhimin e plotë se do të sigurojë një sistem gjyqësor të drejtë i cili mbështetet në parimet e pavarësisë, llogaridhënies, transparencës dhe të efijencës, në mbledhjen e datës 12.12.2018 u deklarua krijimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor.¹⁵

Ndryshimet Kushtetuese sollën ndryshime rrënjësore dhe fuqizim të rolit të organit qeverisës të pushtetit gjyqësor- KLGJ-së. Disa nga risitë dhe avantazhet të cilat paraqet organizimi i tanishëm janë:

- ndarja e qartë e detyrave dhe e përgjegjësisive ndërmjet institucioneve të drejtësisë duke nxitur në të njëjtën kohë bashkëpunimin ndërmjet tyre;
- rishikimi i përbërjes së KLGJ duke filluar nga mënyra e zgjedhjes së anëtarëve të saj dhe përfshirja e përfaqësuesve të shoqërisë civile, avokatisë edhe fushës akademike duke ngushtuar diferencën mes anëtarëve gjyqtarë dhe anëtarëve jo gjyqtarë;
- mos përfshirja e Ministrisë të Drejtësisë në radhët e anëtarëve është një hap tjetër drejt ndarjes së qartë të pushtetit ekzekutiv nga gjyqësori;
- anëtarësia me kohë të plotë dhe parashikimi i ngritjes së komisioneve të përhershme, ndërthurur me transparencën në vendimmarrje pritet të krijojë kushte për një funksionalitet dhe efijencë më të mirë nga ana e KLGJ krahasuar me institucionin pararendës.

3.1 Mbledhjet Plenare

Që nga momenti i zhvillimit të mbledhjes së tij të parë dhe përgjatë katër muajve të parë, KLGJ duhet jo vetëm të ngrihet institucionalisht por edhe t'i përgjigjej sa më shpejt detyrimeve ligjore.

Deri më tani KLGJ ka zhvilluar 17¹⁶ mbledhje plenare dhe janë marrë 68 vendime, të cilat kanë pasur në fokus:

(i) rregullimin e veprimtarisë së KLGJ-së;

¹⁴ 5 anëtarë jogjyqtarë të zgjedhur nga Kuvendi i Shqipërisë me vendimin Nr.18 datë 08.02.2018 dhe 6 anëtarë gjyqtarë të zgjedhur nga Mbledhja e Përgjithshme e Gjyqtarëve më datë 12.12.2018.

¹⁵ Vendimi Nr. 4, datë 20.12.2018,

¹⁶ të datave: 20.12.2018, 21.12.2018, 27.12.2018, 10.01.2019, 18.01.2019, 22.01.2019, 29.01.2019, 31.01.2019, 07.02.2019, 14.02.2019, 19.02.2019, 28.02.2019, 12.03.2019, 18.03.2019, 27.03.2019, 19.04.2019 dhe 24.04.2019;

(ii) mirë administrimin e gjykatave nëpërmjet rregulloreve të ndryshme si, skema e delegimit, transferimi i përkohshëm i gjyqtarëve, caktimi i gjyqtarëve për gjykimin në çështje të veçanta në gjykata të tjera, zgjedhja e zëvendëskryetarëve të gjykatave.

(iii) statusin e gjyqtarëve duke përfshirë nisjen e procesit të emërimit të magjistratëve të rinj, nisjen e procedurës për caktimin e përkohshëm të gjyqtarëve në Gjykatat e Posaçme për Gjykimin e Veprave Penale të Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, mbarimin e statusit të magjistratit për shkak të daljeve në pension, përfundimit të mandatit, dorëheqjeve, etj.

Pas zgjedhjes së organeve drejtuese, të kryetarit¹⁷ dhe të zëvendëskryetarit¹⁸, si dhe të anëtarëve të cilat do të ushtrojnë detyrën me mandat 3-vjeçar, vlen të theksojmë se përgjatë kësaj periudhe KLGJ ka miratuar rreth 7 vendime¹⁹, të karakterit rregullator, dhe 7 vendime²⁰ të cilat kanë të bëjnë me ngritjen dhe përbërjen e komisioneve të përhershme ashtu dhe të komisioneve të përkohshme.

Disa nga çështjet me të cilat u përball KLGJ, të cilat kërkonin ndërhyrje të menjëhershme, paraqiten më poshtë:

- Vakumi në sistemin e drejtimit në gjykata si pasojë e shkarkimit të kryetarëve të gjykatave gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar;
- Nisja e procesit të caktimit të përkohshëm të gjyqtarëve pranë Gjykatave së Posaçme për Gjykimin e Veprave Penale të Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, kur ligji parashikonte një afat dy javor nga krijimi i KLGJ-së;
- Nisja e procesit të emërimit dhe caktimi në detyrë i magjistratëve të cilët kanë përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2018 dhe pranimet e reja në Shkollën e Magjistraturës për vitin 2019-2020;
- Ngritja e strukturës përkatëse për vijimin e bashkëpunimit me institucionet të rivlerësimit kalimtar;

¹⁷ vendimi nr.2 datë 20.12.2018, zgjedhja e znj. Naureda Llagami Kryetare e KLGJ

¹⁸ vendimi nr.3 datë 20.12.2018, zgjedhja e z. Maksim Qoku zëvendëskryetar.

¹⁹ Vendim Nr.1 datë 20.12.2018 - Mbi miratimin e rregullave për zgjedhjen e kryetarit dhe të zëvendëskryetarit të këshillit të lartë gjyqësor.

Vendim Nr.7 datë 21.12.2018 - Rregullore për miratimin e rregullave për zgjedhjen e zëvendëskryetarëve të gjykatave.

Vendim Nr.22 datë 7.02.2019 - Mbi miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurën e funksionimit të skemës së delegimit të gjyqtarit.

Vendim Nr.23 datë 7.02.2019 - Mbi miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurën e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit.

Vendim Nr.24 datë 7.02.2019 - Mbi miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e komisionit të përkohshëm për vlerësimin etik dhe profesional në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve.

Vendim Nr.30 datë 14.02.2019 - Mbi miratimin e vendimit për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme.

Vendim Nr.52 datë 27.03.2019 - Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e komisionit të përkohshëm për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të kryeinspektorit të ish-këshillit të lartë të drejtësisë për arkivimin e ankesës ose pushimin e hetimit ndaj një gjyqtari.

²⁰ Vendim Nr.13 datë 18.01.2019 - Mbi ngritjen dhe përbërjen e komisioneve të përhershme të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Vendim Nr.15 datë 22.01.2019 - Ngritjen e komisionit të përkohshëm për vlerësimin etik dhe profesional në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve.

Vendim Nr.18 datë 29.01.2019 - Mbi ngritjen e komisionit të përkohshëm për verifikimin e plotësimit të kriterëve të kandidatëve për këshilltarë dhe ndihmës ligjorë, që do të pranohen për të ndjekur programin e formimit fillestar pranë shkollës së magjistraturës, për vitin akademik 2019-2020.

Vendim Nr.19 datë 29.01.2019 - Mbi përbërjen e komisionit të përkohshëm për verifikimin e plotësimit të kriterëve të kandidatëve për këshilltarë dhe ndihmës ligjorë.

Vendim Nr.31 datë 02.02.2019 - Mbi ngritjen e komisionit të përkohshëm për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të kryeinspektorit të ish këshillit të lartë të drejtësisë për arkivimin e ankesës ose pushimin e hetimit ndaj një gjyqtari.

Vendim Nr.32 datë 14.02.2019 - Mbi përbërjen e komisionit të përkohshëm për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të kryeinspektorit të ish këshillit të lartë të drejtësisë për arkivimin e ankesës ose pushimin e hetimit ndaj një gjyqtari.

Vendim Nr.53 datë 27.03.2019 - Për caktimin e anëtarëve zëvendësues në komisionin e përkohshëm për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të kryeinspektorit të ish këshillit të lartë të drejtësisë, për arkivimin e ankesës ose pushimin e hetimit ndaj një gjyqtari.

- Ngritja e komisioneve të përhershme sipas parashikimeve ligjore ashtu dhe komisioneve të përkohshme si një domosdoshmëri për të shqyrtuar çështje të veçanta;
- Vlerësimi i situatës dhe ngritja e komisionit për shqyrtimin e ankesave të subjekteve kundër vendimeve të Kryeinspektorit të ish Këshillit të Lartë të Drejtësisë për arkivimin e ankesës ose pushimin e hetimit ndaj një gjyqtari, si përgjegjësi ligjore e KLGJ;
- Trajtimi i një numri të madh kërkesash të ardhura nga gjykatat ku kërkohej delegimi i gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve të caktuara;
- Ngritja e një strukture të mirë organizuar në shërbim të Këshillit dhe Komisioneve;

Duke marrë në konsideratë problematikat e shfaqura, KLGJ ndërmori hapat e nevojshme për adresimin dhe zgjidhjen e tyre, konkretisht në lidhje me:

3.1.1 Vakumin në sistemin e drejtimit në gjykata si pasojë e shkarkimit të kryetarëve të gjykatave gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar

Në lidhje me vakumin në sistemin e drejtimit në gjykata si pasojë e shkarkimit të kryetarëve të gjykatave gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar, KLGJ pasi analizoi kuadrin ligjor, në kushtet kur zgjedhja e kryetarëve të rinj kërkonte kohë dhe procedura të mirë përcaktuara, vlerësoi se legjislacioni në fuqi, parashikonte që në mungesë të kryetarit, detyrën e tij e kryen zëvendëskryetari. Ndaj në këtë drejtim, doli si domosdoshmëri, hartimi i një vendimi që përcaktonte rregulla të detajuara për zgjedhjen e zëvendëskryetarëve të gjykatave. Kjo rregullore u miratua në mbledhjen e datës 21.12.2018²¹ duke i hapur kështu rrugën procesit të zgjedhjes së zëvendëskryetarëve në gjykata, dhe duke i dhënë një zgjidhje përfundimtare situatave që krijoheshin pas shkarkimeve nga detyra të disa kryetarëve në gjykata me vendim të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit ose mbarimit të statusit të gjyqtarit në rast dorëheqjeje ose mbushje të moshës për pension, pezullimeve, etj. Bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, në mungesë të kryetarit të gjykatës, kompetencat e tij i ushtron zëvendëskryetari. Deri me datë 30.04.2019, nën monitorimin e KLGJ-së, janë zgjedhur zëvendëskryetarët në 36 gjykata, nga 37 gjykata të nivelit të parë dhe apelit nën juridiksionin e KLGJ.

3.1.2 Caktimin e përkohshëm të gjyqtarëve pranë Gjykatave së Posaçme për Gjykimin e Veprave Penale të Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, kur ligji parashikonte një afat dyjavor nga krijimi i KLGJ-së

Bazuar në ndryshimet kushtetuese, të cilat në nenin 135 parashikojnë transformimin e gjykatave të shkallës së parë dhe të apelit për krimet të rënda në Gjykata të Posaçme për Gjykimin e Veprave Penale të Korrupsionit dhe të Krimit të Organizuar, si dhe bazuar në nenin 162 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ku parashikohen kriteret që duhet të plotësohen për të qenë pjesë e gjykatave të posaçme, KLGJ nisi procedurën²² për caktimin e përkohshëm të gjyqtarëve pranë Gjykatave së Posaçme për Gjykimin e Veprave Penale të Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar duke i hapur rrugë krijimit të këtyre gjykatave. Krijimi i Gjykatave të Posaçme për Gjykimin e Veprave Penale të Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar përbën një gur themeli, në arritjen e pritshmërive që ka opinioni publik sa i përket reformës në sistemin e drejtësisë. Në këtë kuadër është kërkuar nga gjyqtarët në

²¹ Vendimi nr.7 datë 21.12.2018

²² vendimi nr.9 datë 27.12.2018

detyrë të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda dhe të Apelit, të cilët dakordësohen për të vijuar ushtrimin e detyrës së gjyqtarit pranë gjykatës së posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar:

- të shprehin interesin e tyre me shkrim,
- së bashku me familjarët e tyre të japin pëlqimin për kontrollin periodik të llogarive të tyre bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas parashikimeve ligjore.

Mbi këtë kërkesë, kanë dhënë pëlqimin pranë KLGJ 14 nga 15²³ gjyqtarë të cilët ushtrojnë detyrën pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, ndërkohë nga 11 gjyqtarë që ushtrojnë detyrën pranë Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda, kanë dhënë pëlqimin 8 gjyqtarë.

3.1.3 Nisje e procesit të emërimit dhe caktimi në detyrë i magistratëve të cilët kanë përfunduar Shkollën e Magjistraturës (SHM) në vitin 2018 dhe pranimet e reja në SHM

Emërimi dhe caktimi në detyrë i magistratëve që kanë përfunduar Shkollën e Magjistraturës, është një nga detyrimet që ka KLGJ. Kjo procedurë është parashikuar në ligjin nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë". Në korrik të vitit 2018, kanë përfunduar Shkollën e Magjistraturës, brezi i studentëve, të cilët nuk janë të emëruar dhe caktuar në gjykata. Nisur nga detyrimi por dhe nga nevoja që ka emërimi i tyre, KLGJ menjëherë, në mbledhjen e saj të tretë më datë 27.12.2018²⁴, vendosi të fillojë procesin e emërimit të kandidatëve për magistratë të cilët janë diplomuar nga Shkolla e Magjistraturës në vitin 2016 duke kërkuar nga institucionet kompetente raportim për verifikimin e pasurisë dhe të figurës së kandidatëve, siç parashikohet në nenin 32, pika 2 e ligjit nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë. Emërimi përfundimtar i magistratëve do plotësojë një pjesë të vakancave në gjykata të cilat kanë ardhur si pasojë e largimeve prej procesit të vettingut, mbushjes së moshës së pensionit të disa gjyqtarëve, dorëheqjes, etj. Aktualisht KLGJ është në fazën e mbledhjes së dokumentacionit nga institucionet përgjegjëse në mënyrë që të vijojë me ndjekjen e të gjitha procedurave të tjera të parashikuara në ligj dhe të emërojë dhe caktojë magistratët në detyrë.

Gjithashtu, Këshilli, duke analizuar nevojat që sistemi ka dhe mundësitë që ka Shkolla e Magjistraturës, miratoi²⁵ "Numrin e kandidatëve për t'u pranuar në programin fillestar të trajnimit në Shkollën e Magjistraturës për vitin akademik 2019-2020" përkatësisht 25 pozicione për kandidatë për magistratë, dhe 25 pozicione për kandidatë për këshilltarë dhe ndihmës ligjorë.

Në vijim të këtij procesi, Këshilli me vendimin nr. 43, datë 12.03.2019, miratoi listën emërore të kandidatëve për Këshilltarë dhe Ndihmës Ligjorë, që plotësojnë kriteret për të marrë pjesë në provimin e pranimit në programin e formimit fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2019-2020, si dhe në mbledhjen e datës 27 mars 2019m pasi shqyrtoi raportin për rezultatet e vlerësimit paraprak të kandidatëve aplikues për pranimin në Formimin Fillestar për vitin akademik 2019-2020, dërguar nga Shkolla

²³ gjyqtar D. H., duke filluar nga 12 dhjetori 2018 është anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor

²⁴ vendimi nr.8 datë 27.12.2018

²⁵ vendimin nr. 17, datë 29.01.2019

e Magjistraturës, bazuar në nenin 30, të ligjit nr.96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, miratoi Komentet dhe Kundërshtimet në lidhje me këtë raport.

3.1.4 Ngritja e strukturës përkatëse për vijimin e bashkëpunimit me institucionet e rivlerësimit kalimtar

Duke mbajtur parasysh rëndësinë për vazhdimin e procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve, me ngritjen e KLGJ u ngrit gjithashtu edhe Komisioni i Përkohshëm për Vlerësimin Etik dhe Profesional në Kuadër të Procesit të Rivlerësimit Kalimtar të gjyqtarëve dhe të subjekteve të tjera të rivlerësimit. Deri më tani në bashkëpunim me Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, janë organizuar **76 shorte** për përzgjedhjen e 5 dosjeve për 76 subjekte të rivlerësimit kalimtar. Pas organizimit të shorteve për përzgjedhjen e dosjeve, KLGJ ka kërkuar gjithsej **360 dosje** gjyqësore/dokumente ligjore në gjykatat respektive ku administrohen këto akte, secila prej tyre në 2 kopje (një kopje për Komisionin e Pavarur të Kualifikimit (KPK) dhe një kopje për Operacionin Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM). Kjo fazë ka patur disa vështirësi në rastet kur dosja gjyqësore ka lëvizur nga njëra gjykatë tek tjetra.

KLJGJ ka proceduar me depozitimin e raporteve dhe të dosjeve gjyqësore pranë KPK-së grupuar sipas institucioneve. Bazuar në këtë qasje janë depozituar pranë KPK-së gjithsej **41 raporte** të hollësishme dhe të arsyetuara, të shoqëruara me 205 dosje gjyqësore për 41 subjekte rivlerësimi. Aktualisht janë miratuar nga Komisioni i Përkohshëm për Vlerësimin Etik dhe Profesional në Kuadër të Procesit të Rivlerësimit Kalimtar të gjyqtarëve dhe janë gati për t’u dorëzuar një paketë tjetër prej 3 raportesh për 3 subjekte rivlerësimi.

Aktualisht, inspektorët pranë KLGJ-së, janë në proces hartimi të raportit për **159 subjekte** rivlerësimi, duke përfshirë edhe procesin e zhvillimit të shortit dhe pritjes së dosjeve nga gjykatat respektive. Në shtesë të shorteve të plota të përshkruara më sipër, është organizuar shorti i pjesshëm për **3 subjekte** të tjera rivlerësimi, të cilët ishin filluar më herët nga ish-KLD.

Gjatë gjithë procesit të punës KLGJ ka ndjekur udhëzimet e KPK-së. Gjithashtu me kërkesë të shprehur të ONM-së, i gjithë dokumentacioni që depozitohet pranë KPK-së i është përcjellë edhe ONM-së. Kopjet e raporteve përfundimtare janë përcjellë përveçse fizikisht edhe në rrugë elektronike pranë të dyja institucioneve.

Duke mbajtur parasysh interesin që procesi i rivlerësimit të kryhet pa vonesa dhe duke monitoruar ecurinë e procesit koordinues midis gjykatave, KLGJ dhe KPK deri më tani, evidentohet se:

1. Ka një mos rakordim nga ana e gjykatave në lidhje me vendndodhjen e dosjeve, gjë e cila sjell një punë voluminoze për të gjurmuar dosjen deri në marrjen e saj. Kjo mungesë informacioni ka sjellë rrjedhimisht vonesa në hartimin e raportit dhe dorëzimin pranë KPK-së.
2. Aktet e nisura nga gjykatat në disa raste kanë patur mangësi dhe kjo ka bërë që kërkesat të ripërsëriten dhe afati i dorëzimit të dokumentacionit të tej zgjatet.

3.1.5 Verifikimi i kritereve ligjore për kancelarët në detyrë

Gjithashtu, bazuar në ligjin nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, neni 83, i cili parashikon që brenda gjashtë muajve nga

krijimi i KLGJ-së, institucioni të fillojë verifikimin për plotësimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të pozicionit, si dhe bën verifikimin e figurës dhe të pasurisë për kancelarët në detyrë. Në përmbushje të këtij detyrimi KLGJ ka filluar procesin e verifikimit paraprak të të gjithë kancelarëve në detyrë, 37 kancelarë (8 kancelarë nga gjykatat e apeleve, 23 kancelarë nga gjykatat e rretheve gjyqësore, 6 kancelarë nga gjykatat e shkallëve të para administrative). Ndërkohë që KLGJ në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës dhe mbështetjen e Projektit “Drejtësi për të Gjithë” (USAID) nga data 6 qershor – 26 korrik do të organizojë një program trajnimi për të gjithë kancelarët e gjykatave mbi standardet ndërkombëtare dhe praktikat më të mira të administrimit gjyqësor.

3.1.6 Ngritja e komisioneve të përhershme dhe komisioneve të përkohshme si një domosdoshmëri për të shqyrtuar çështje të veçanta

Si një detyrim i parashikuar nga ligji nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, por edhe si një domosdoshmëri për mirëfunksionimin e Këshillit, me ngritjen e KLGJ u realizua dhe ngritja e komisioneve të përhershme dhe të përkohshme. Në nenin 62, pika 2 e ligjit nr.115/2016 parashikohet që pas zgjedhjes së Kryetarit, Këshilli merr vendim për përbërjen e komisioneve të përhershme duke përfshirë edhe anëtarët zëvendësues. Duke marrë në konsideratë funksionet që Këshilli ka, ligjvënësi ka projektuar edhe fushat e veprimtarisë së këtyre komisioneve, numrin e përbërjes së tyre dhe funksionimin e tyre si prime të përgjithshme.

Në mbledhjen e tij të datës 18.01.2019, në mbështetje të nenit 62 të ligjit nr.115 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” me vendimin nr. 13, datë 18.01.2019, Këshilli i Lartë Gjyqësor vendosi ngritjen dhe përbërjen e komisioneve të përhershme, caktimin e anëtarëve të komisioneve dhe anëtarëve zëvendësues. Ky organizim u krye duke mbajtur parasysh nevojën për të garantuar një shpërndarje të drejtë të ngarkesës së punës, respektimin e raporteve midis anëtarëve gjyqtarë dhe jo gjyqtarë dhe specializimin e secilit anëtar të KLGJ.

3.1.7 Vlerësimi i situatës dhe ngritja e komisionit për shqyrtimin e ankesave të subjekteve kundër vendimeve të Kryeinspektorit të ish Këshillit të Lartë të Drejtësisë

Sa i përket vendimmarrjes së Kryeinspektorit të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë, KLGJ me krijimin e saj gjeti të depozituar 183 ankimime. Situata kërkonte një vendimmarrje për arkivimin e ankesës ose pushimin e hetimit ndaj një gjyqtari. Duke vlerësuar këtë situatë, por në të njëjtën kohë duke përmbushur detyrimin e parashikuar në nenin 62, pika 13 të ligjit nr.115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, Këshilli ngriti një komision të përkohshëm²⁶ i cili do të shqyrtojë të gjitha ankimet kundër vendimeve të Kryeinspektorit të ish- Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Pas shqyrtimit fillestar të ankesave ky komision do të vlerësojë nëse kërkesa duhet arkivuar apo duhet mbyllur hetimi ndaj veprimtarisë gjyqësore të magjistratit.

3.1.8 Trajtimi i një volumi të madh me kërkesa të ardhura nga gjykatat ku kërkohej delegimi i gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve të caktuara

Në vijim të çështjeve të rëndësishme me të cilat KLGJ është përballuar menjëherë me krijimin e saj ishte edhe numri i lartë i kërkesave të ardhura nga kryetarët e gjykatave të cilat kërkonin delegim gjyqtarësh për plotësimin e trupave gjyqësore. Arsyet për të cilat

²⁶ Vendimi nr. 31, datë 14.02.2019.

kërkohej delegimi i gjyqtarëve ishte pamundësia për shqyrtimin e një apo disa çështjeve gjyqësore brenda afateve të arsyeshme kohore. Caktimi i gjyqtarëve për plotësimin apo formimin e trupit gjykues për llogari të gjykatave në nevojë është e domosdoshme duke mbajtur parasysh situatën e gjykatave ku disa prej tyre kanë organikë të cunuar dhe nuk plotësojnë dot trupat gjykues, apo rastet kur gjyqtarët e gjykatës janë në kushtet e pamundësisë për gjykimin e një çështjeje gjyqësore (heqje dorë, pranimit të kërkesave për përjashtim, të vendimmarrjeve të mëparshme apo konfliktet e interesit). Në këto kushte, bazuar në nenin 147 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë për të garantuar të drejtën e individëve për gjykimin e çështjes brenda afateve të arsyeshme, si një përgjegjësi për mbarëvajtjen dhe mirë administrimin e pushtetit gjyqësor, Këshilli filloi procesin e krijimit të skemës së delegimit si dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarëve. Komisioni për Zhvillimin e Karrierës përgatiti rregulla të hollësishme për krijimin dhe aplikimin e skemës së delegimit dhe asaj të transferimit të përkohshëm.

Këto rregullore u shqyrtuan dhe u miratuan në mbledhjen e KLGJ të datës 07.02.2019, respektivisht me vendimet nr. 22²⁷, dhe nr. 23²⁸, si dhe në zbatim të nenit 98, pika 4 të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, u botuan në Fletoren Zyrtare²⁹. Gjithashtu në funksion të këtij procesi iu kërkuar kryetarëve të gjykatave që të bënin me dije trupën gjyqësor për këto vendime, për të shprehur pëlqimin për pjesëmarrje në skemën e delegimit.

Hartimi i rregulloreve është konsultuar në mënyrë konsekuente me projektin EURALIUS dhe JUST të USAID të cilët kanë asistuar KLGJ me ekspertizë veçanërisht në ditët e para të krijimit të saj.

Ndërkohë që delegimet e aplikuara gjatë mandatit të ish-KLD ishin të tilla që lejonin delegimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve të veçanta në një gjykatë tjetër nga ku gjyqtari ushtronte detyrën e përhershme, legjislacioni tashmë ka krijuar një skemë të re delegimi e cila parashikon ngritjen e një grupi të gatshëm gjyqtarësh të cilët me pëlqimin e tyre futen në këtë skemë dhe si rrjedhojë mund të dërgohen sipas rastit dhe nevojës në gjykata të tjera.

Megjithatë, duke u gjendur në kushtet kur për kandidimin në skemën e delegimit dhanë pëlqimin vetëm 4 (katër) gjyqtarë të cilët nuk plotësonin kriteret, si dhe për transferimin në mënyrë të përkohshme në një gjykatë tjetër nuk shprehu pëlqimin asnjë gjyqtar - Këshilli, i ndodhur përpara pamundësisë së disponimit të gjyqtarëve në Skemën e Delegimit dhe të Transferimit të Përkohshëm, si dhe përballë një numri prej **184 kërkesave nga kryetarët e gjykatave për delegime të 266 gjyqtarëve**, bazuar në detyrimin Kushtetues që ka për të siguruar pavarësinë, përgjegjshmërinë dhe mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor, miratoi me vendimin nr. 30, datë 14.02.2019, “Rregullat dhe procedurat për caktimin e gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”. Kjo përgjegjshmëri e KLGJ bëri që t’i jepej zgjidhje caktimit të gjyqtarëve në gjykata dhe numrit të madh të kërkesave për gjyqtarë për çështje të caktuara të ardhura nga gjykatat në nevojë konkretisht nga 7 (shtatë) gjykata të apeleve dhe 19 (nëntëmbëdhjetë) gjykata të rretheve gjyqësore.

Ndërkohë, deri në fund të muajit prill 2019, rezultoi se pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor (KLGJ) janë depozituar nga kryetarët respektivë të gjykatave gjithsej 327 kërkesa për 427 raste delegimesh gjyqtarësh. Në përgjigje të këtyre kërkesave, Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në vendimin nr. 30 datë 14.02.2019, ka proceduar me caktimin e

²⁷ Vendim Nr.22 datë 7.02.2019 - Mbi miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurën e funksionimit të skemës së delegimit të gjyqtarit.

²⁸ Vendim Nr.23 datë 7.02.2019 - Mbi miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurën e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit.

²⁹ Fletorja Zyrtare nr.12, date 07.02.2019.

gjyqtarëve në gjykatat në nevojë duke mbajtur në konsideratë jo vetëm përzgjedhjen rastësore sipas shortit por dhe një shpërndarje të drejtë të ngarkesës të gjyqtarëve në gjykatën ku ushtron funksionin.

3.1.9 Ngritja e komisioneve dhe strukturës administrative në shërbim të KLGJ

Për të bërë të mundur përmbushjen e detyrimeve dhe përgjegjësi që Kushtetuta dhe kuadri ligjor në mbështetje të tij ngarkon Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe për ta bërë funksional institucionin është e domosdoshme që ky i fundit të ketë (i) strukturën organizative të tij dhe të administratës së tij; (ii) përcaktimin e detyrave dhe përgjegjësi të të gjitha njësive organizative dhe të pozicioneve individuale; (iii) rregullat procedurale, sipas të cilave vepron administrata në mënyrë të atillë që të sigurojë mbështetje efikase dhe efektive për Këshillin dhe komisionet e tij.

Duke marrë në konsideratë sa më sipër, Këshilli miratoi³⁰ strukturën organizative të administratës së tij, e cila iu dërgua Kuvendit të Shqipërisë për aprovim. Mbështetur në vlerësimin e Kuvendit të Shqipërisë si dhe në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike³¹ u miratua struktura përfundimtare. Kjo strukturë e re ka një rritje të numrit të punonjësve me rreth 30%, në krahasim me strukturën e institucionit pararendës, e cila nga 82 punonjës³², tashmë ka 125 punonjës duke përfshirë dhe anëtarët e KLGJ-së.

3.2 VEPRIMTARIA E KOMISIONEVE TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

3.2.1 Komisionet e përhershme

Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit përbëhet nga 3 anëtarë (2 anëtarë jo gjyqtarë dhe 1 anëtar gjyqtar).

Ky komision e ushtron veprimtarinë dhe merr vendime në fushën e planifikimit strategjik dhe buxhetit si dhe bazuar në nenin 62, pika 1 të ligjit nr.115/2016 mund t'i propozojë mbledhjes plenare të Këshillit miratimin e vendimeve që janë në kompetencë të këtij të fundit. Ky komision, që nga momenti i ngritjes së tij, ka shqyrtuar dhe vendosur në lidhje me 3 çështje duke i propozuar mbledhjes plenare (i) hartimin e strukturës organizative të KLGJ-së me departamentet dhe njësitë përkatëse; (ii) ngritjen e Komisionit të Përkohshëm për vlerësimin e statusit individual dhe karrierën e inspektorëve të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë, si dhe (iii) caktimin e një anëtari të Këshillit të Lartë Gjyqësor për kryerjen e detyrave në lidhje me marrëdhëniet me publikun. Gjithashtu është në fazën e finalizimit dhe hartimi i Planit Strategjik dhe ai i veprimit të institucionit të KLGJ-së.

Komisioni Disiplinor ka në përbërje tre anëtarë (2 anëtarë gjyqtarë dhe 1 anëtar jo gjyqtar).

Komisioni shqyrton paraprakisht rastet e procedimeve disiplinore kundër një gjyqtari të cilat paraqiten nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe bazuar në nenin 62, pika 1 të ligjit nr.115/2016 mund t'i propozojë mbledhjes plenare të Këshillit miratimin e vendimeve që janë në kompetencë të këtij të fundit. Ky komision, nga momenti i ngritjes së tij, ka shqyrtuar dhe vendosur në lidhje me 1 çështje³³.

³⁰ Me vendimin nr.12, datë 18.01.2019 ndryshuar me vendimin nr.44, datë 12.03.2019. Organigrama sipas Aneksi 1 bashkëlidhur këtij raporti.

³¹ Shkresa nr. 1394 prot., datë 04.03.2019 drejtuar Departamentit të Administratës Publike.

³² KLGJ e përbërë nga 11 anëtarë; ish-KLD me organigramë me 50 punonjës, ish-ZABGJ me organigramë me 21 punonjës.

³³ Vendim Nr.11 datë 10.01.2019 "Mbi pezullimin e gjyqtarit R.H"

Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale ka në përbërje 3 anëtarë (2 anëtarë gjyqtarë dhe 1 anëtar jo gjyqtar).

Bazuar në nenin 62, pika 4 të ligjit nr.115/2016, pranë këtij komisioni u zgjedhën dhe 2 anëtarë zëvendësues (1 anëtar jo gjyqtar dhe 1 anëtar gjyqtar). Ky komision jep mendime për përcaktimin dhe përditësimin e sistemit të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve. Jep mendime në lidhje me kërkesat për ushtrimin e veprimtarisë akademike të gjyqtarëve, bën raporte dhe propozime për organizimin e kurseve për formimin profesional pranë Shkollës së Magjistraturës të gjyqtarëve. Gjithashtu ky komision përgatit raporte për fluksin e punës në gjykata, kohëzgjatjen e proceseve, për mosfunksionimin e punës në gjykata dhe shkaqet e tyre. Në përfundim të shqyrtimit të çështjeve, komisioni përgatit raport përkatës për në Këshill.

Bazuar në nenin 62, pika 1 të ligjit nr.115/2016, ky komision mund t'i propozojë mbledhjes plenare të Këshillit miratimin e vendimeve që janë në kompetencë të këtij të fundit. Ky komision, nga momenti i ngritjes së tij, ka shqyrtuar dhe vendosur në lidhje me 5 çështje, specifikisht, kontributi i këtij komisioni ka qenë në vendimmarrjet lidhur me (i) informacionin periodik të kryetarëve të gjykatave në lidhje me veprimtarinë gjyqësore; (ii) udhëzimin për pagesat e gjyqtarëve në ditët e pushimit javor dhe festave zyrtare; (iii) sugjerime drejtuar Shkollës së Magjistraturës; (iv) dhënie leje për arsye shëndetësore për një gjyqtar; (v) përjashtimin nga shorti për një periudhë tremujore të dy gjyqtarëve, njëkohësisht anëtarë të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka në përbërje 3 anëtarë (2 anëtarë gjyqtarë dhe 1 anëtar jo gjyqtar).

Ky komision shqyrton kërkesat për emërimë në gjykata sipas kritereve të përcaktuara nga Këshilli, duke paraqitur një raport para mbledhjes plenare i cili shoqërohet me tabelat dhe listën e kandidatëve të pikëzuar. Gjithashtu ky komision raporton në Këshill për kandidatët për funksionin drejtues në gjykata, si dhe ndjek procesin e plotësimit të vendeve vakante në gjykata, transferimet si dhe procedurat lidhur me skemën e delegimit. Gjithashtu ky komision shqyrton kërkesat e Shkollës së Magjistraturës për numrin e magistratëve të rinj, emërimin dhe caktimin në pozicion të kandidatëve të diplomuar. Bazuar në nenin 62, pika 1 të ligjit nr.115/2016, ky komision mund t'i propozojë mbledhjes plenare të Këshillit miratimin e vendimeve që janë në kompetencë të këtij të fundit. Ky komision, nga momenti i ngritjes së tij, ka shqyrtuar dhe vendosur në lidhje me 15 çështje.

Veprimtaria e këtij komisioni është shumë produktive për shkak të fushës së veprimtarisë që mbulon, problematikave që dalin në vazhdimësi dhe nevojës për të dhënë opinione apo propozime nga ana e tij. Angazhimi i këtij komisioni përgjatë kësaj periudhe ka qenë në hartimin e rregulloreve të ndryshme, si për skemën e delegimit, për transferimin e përkohshëm të gjyqtarëve ashtu si dhe për rregullat për caktimin e gjyqtarëve për të gjykuar çështje të veçanta në gjykata të tjera. Kontribut tjetër është dhënë edhe në caktimin e numrit të kandidatëve që do të pranohen në programin e formimit fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2019-2020, në ngritjen e komisionit të përkohshëm për verifikimin e plotësimit të kandidatëve për këshilltarë dhe ndihmës ligjorë, në dhënien e opinionit për komandimin e një gjyqtari në pozicionin pedagog i brendshëm në Shkollën e Magjistraturës, në caktimin e gjyqtarëve për zhvillimin e praktikës profesionale të studentëve të Shkollës së Magjistraturës, në deklarimin e mbarimit të statusit për disa magistratë, ashtu si dhe në çdo në mbledhje kryen procedurat e nevojshme për caktimin e gjyqtarëve në gjykata të tjera, për gjykimin e çështjeve të veçanta.

3.2.2 Komisionet e përkohshme

Komisioni i Përkohshëm për Vlerësimin Etik dhe Profesional në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe të subjekteve të tjera të rivlerësimit³⁴

Ky komision koordinon punën e tij me institucionet e rivlerësimit si dhe me Këshillin e Lartë Gjyqësor për përmbushjen e detyrave të tij përgjatë këtij procesi. Është miratuar edhe Rregullorja “Mbi organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Përkohshëm për Vlerësimin Etik dhe Profesional në Kuadër të Procesit të Rivlerësimit Kalimtar të Gjyqtarëve”³⁵, në të cilën përcaktohen rregulla të hollësishme për mirëfunksionimin e këtij procesi.

Ky Komision në bashkëpunim me Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, ka organizuar **76 shorte** për përzgjedhjen e 5 dosjeve për 76 subjekte të rivlerësimit kalimtar, si dhe ka kërkuar gjithsej **360 dosje** gjyqësore/dokumente ligjore në gjykatat respektive. Janë depozituar pranë KPK-së gjithsej **41 raporte** të hollësishme dhe të arsyetuara, të shoqëruara me 205 dosje gjyqësore për 41 subjekte rivlerësimi. Aktualisht, një paketë tjetër prej 3 raportesh për 3 subjekte rivlerësimi është miratuar dhe është gati për t’u dorëzuar nga Komisioni i Përkohshëm për Vlerësimin Etik dhe Profesional në Kuadër të Procesit të Rivlerësimit Kalimtar të gjyqtarëve.

Komisioni i Përkohshëm për Verifikimin e Plotësimit të Kriterëve të Kandidatëve për Këshilltarë dhe Ndhmës Ligjorë, që do të pranohen për të ndjekur programin e formimit fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2019-2020³⁶

Brenda muajit Janar Këshilli i Lartë Gjyqësor, vendosi³⁷ caktimin dhe publikimin e numrit maksimal të kandidatëve magistratë, profili gjyqtar, prej 25 (njëzet e pesë) kandidatë që do të pranohen në programin e formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2019-2020. Gjithashtu, Këshilli i Lartë Gjyqësor vendosi caktimin e 25 (njëzet e pesë) kandidatëve për këshilltarë dhe ndihmës ligjorë, që do të pranohen për të ndjekur programin e formimit fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2019-2020. Në funksion të këtij vendimi u ngrit edhe Komisioni i Përkohshëm për Verifikimin e Plotësimit të Kriterëve të Kandidatëve për Këshilltarë dhe Ndhmës Ligjorë.

Komisioni i përkohshëm për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Kryeinspektorit të ish Këshillit të Lartë të Drejtësisë për arkivimin e ankesës ose pushimin e hetimit ndaj një gjyqtari³⁸ - Për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për arkivimin e ankimit ose pushimin e hetimit ndaj një gjyqtari, u ngrit një komision i përkohshëm i përbërë nga 2 anëtarë jo gjyqtarë dhe 1 anëtar gjyqtar. Vendimet e komisionit të përkohshëm janë përfundimtare dhe nuk mund të apelojnë para mbledhjes plenare të Këshillit. KLGJ ka miratuar tashmë edhe Rregulloren për funksionimin e tij.³⁹

Komisionit të Përkohshëm për Vlerësimin e Statusit Individual dhe karrierën e inspektorëve të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë - si një domosdoshmëri për të dhënë zgjidhje cilët ndër inspektorë do të jenë pjesë e KLGJ dhe cilët të zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, është ngritur komisioni i përkohshëm i cili në një periudhë 2-javore nga ngritja e tij, duhet të përfundojë këtë proces. Komisioni përbëhet nga tre anëtarë, 2 anëtarë jo gjyqtarë dhe 1 anëtar gjyqtar.

³⁴ Me vendimin nr. 15 datë 22.01.2019,

³⁵ vendimin nr. 24, datë 07.02.2019

³⁶ vendimin nr. 18, datë 29.01.2019,

³⁷ me vendimin nr.17, datë 29.01.2019,

³⁸ vendimin nr. 31 datë 14.02.2019,

³⁹ vendimin nr.52, datë 27.03.2019.

4 ANALIZA MBI SITUATËN E GJYKATAVE NË SHKALLË VENDI

Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut dhe praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut kërkojnë nga sistemet gjyqësore që të sigurojnë zbatimin e efektshëm të së drejtës për një gjykim të drejtë dhe brenda një kohe të arsyeshme. Programi Kuadër i Komisionit Evropian për Efiçencën e Drejtësisë (CEPEJ) përcakton standarde për trajtimin e çështjeve gjyqësore brenda një periudhe të përshtatshme duke theksuar rëndësinë e parashikimit të kohëzgjatjes së procesit gjyqësor. Gjithashtu, ai vë në dukje ndikimin e ndjeshëm që kanë periudhat pasive (koha në pritje) në kohëzgjatjen e këtij procesi.

Për të adresuar saktësisht problemet dhe për të shmangur vonesat e veprimeve gjyqësore është e domosdoshme jo vetëm mbledhja e informacionit por edhe analizimi i tij përballë treguesve të pritshëm (indikatoreve), kuptimi i arsyeve përse ndodhin këto vonesa dhe përgjigja me masa të përshtatshme emergjente dhe afatgjata. Në këtë kuptim, si pjesë e përgjegjësisë për raportimin mbi situatën në sistemin gjyqësor, KLGJ do të pasqyrojë një tablo faktike sipas shifrave të raportuara nga vetë gjykatat. Në raport do të evidentohen në mënyrë krahasimore ngarkesa në gjykatat e vendit, numri i çështjeve të regjistruara, numri i çështjeve të mbartura, numri i çështjeve të gjykuara - parë kjo (me sa është e mundur) në krahasim me numrin e gjyqtarëve në një gjykatë, shpejtësinë e gjykimit dhe tregues të tjerë të rëndësishëm për një analizë të parë. Kjo analizë do të thellohet më tej gjatë procesit të hartimit të Hartës Gjyqësore, megjithatë në këtë moment të procesit, është e rëndësishme të kuptohen ku janë pikat e nxehta në mënyrë që dhe reagimi i KLGJ të orientohet sipas prioriteteve dhe nevojave emergjente.

Për këtë arsye u pa e nevojshme që pjesë e këtij raporti të bëhet edhe një analizë e parë e veprimtarisë së sistemit gjyqësor për vitin 2018. Pavarësisht mungesës së të dhënave të plota dhe mjeteve për një analizë të thelluar të korrelacionit mes të dhënave dhe treguesve të ndryshëm, kjo analizë statistikore ofron një panoramë të përgjithshme të gjendjes së sistemit gjyqësor në fillim të vitit 2019.

Analiza e veprimtarisë së sistemit gjyqësor është bërë bazuar në:

- a) të dhënat statistikore të dërguara nga gjykatat;
- b) analizën e ndryshimeve ligjore;
- c) gjendjen e burimeve njerëzore në gjykata.

➤ metodologjia

Metodologjia e ndjekur në përgatitjen e kësaj analize është bazuar në sintezën e të dhënave statistikore të dërguara nga vetë gjykatat, sipas një modeli të strukturuar numerik dhe në vijim të kërkesës së Këshillit për informacion, mbi numrin e gjyqtarëve efektivë, numrin e çështjeve të regjistruara në vitin 2018 dhe numrin e çështjeve të mbartura nga viti 2017, numrin e çështjeve të përfunduara në vitin 2018, treguesin e kohës së nevojshme për përfundimin e çështjeve (në ditë), raportin e qarkullimit të çështjeve, koeficientin e shpejtësisë së gjykimit (në %) dhe në numrin e çështjeve të mbartura nga viti 2018 në vitin 2019. Metodologjia statistikore e përdorur bazohet në indikatorët e performancës të parashikuara nga CEPEJ.

➤ mbi të dhënat statistikore të dërguara nga gjykatat

Analiza e gjyqësorit e paraqitur në vijim bazohet në të dhënat statistikore të dërguara nga vetë gjykatat. Bazuar në shifrat e disponueshme dhe përlogaritjet statistikore rezulton se gjykatat kanë vështirësi objektive në nxjerrjen e statistikave të sakta për shkak të disa kufizimeve dhe faktorëve të përmendur në vijim:

1. Të dhënat në tabelat statistikore nxirren ende në mënyre manuale dhe jo nga sistemi ICMIS. Ndonëse të gjitha çështjet pas regjistrimit manual regjistrohen edhe në sistemin ICMIS (duke hedhur aty të gjitha të dhënat si palët, objektin, bazën ligjore, planifikimet, procesverbalet e seancave gjyqësore, vendimet e ndërmjetme dhe përfundimtare etj.), funksionimi i sistemit nuk është efektiv pra nuk gjeneron të dhëna të sakta statistikore. Gjithashtu shpesh ka mospërputhje midis të dhënave të shënuara në regjistra me të dhënat që gjeneron sistemi.
2. Ndryshimet e reja në Kodin e Procedurës Civile dhe Kodin e Procedurës Penale nuk janë pasqyruar në sistemin ICMIS. (p.sh. në K.Pr.Penale ka shtesë për sa i përket seancave paraprake me rezultat një regjistër të shtuar për seancat paraprake: kërkesë për pushim çështje, kërkesë për dërgimin e çështjes në gjyq, etj., por këto ndryshime nuk kanë reflektuar në sistemin e regjistrimit elektronik.
3. Regjistrat në Sekretarinë Gjyqësore kërkojnë një formatim të ri në bazë të ndryshimeve të fundit ligjore, sidomos për regjistrimin dhe evidentimin e gjykimit në seancë paraprake. Në këtë formatim të ri duhet të përfshihen kërkesat e palëve ku duhet të evidentohet dhe një subjekt i ri procedural “viktima”.
4. Sistemi i regjistrimit manual dhe ai elektronik nuk pasqyrojnë ndryshimet për ato gjykata që mbulojnë kërkesat e të dënuarve të IEVP-ve si ulje dënimi, ndryshim të nivelit të sigurisë së burgut dhe kërkesa të tjera në fazën e ekzekutimit.
5. Paqëndrueshmëria e stafit administrativ përgjegjës, mungesa e një metodologjie të unifikuar dhe trajnimit specifik të nëpunësve gjyqësorë.

4.1 ANALIZA E TË DHËNAVE STATISTIKORE⁴⁰

4.1.1 Ngarkesa e gjykatave dhe backlog-u⁴¹ në shkallë vendi

Një nga të dhënat më evidente gjatë krahasimit të të dhënave statistikore është ngarkesa e ndryshme e çështjeve në gjykata të ndryshme të vendit. Ky tregues që duhet marrë parasysh jo vetëm në kuadrin e kësaj analize vjetore por edhe në vijim të rishikimit të hartës gjyqësore. Ndryshimet në nivelin e ngarkesës së çështjeve vjen jo vetëm si rrjedhojë e numrit të popullsisë nën juridiksionin territorial të secilës gjykatë, por edhe në varësi të elementeve të tjerë si p.sh ekzistenca e institucioneve të ekzekutimit të veprave penale të cilat sjellin një numër të shtuar kërkesash nga ana e të dënuarve. Në rivlerësimin territorial të gjykatave duhet mbajtur parasysh raporti i popullsisë së rrethit që mbulon gjykata, numri i çështjeve të regjistruara, numri i gjyqtarëve të gjykatës, volumit të arsyeshëm të punës që të mos ndikohet cilësia e gjykimit, shpejtësia e gjykimit për të dalë në një raport të përshtatshëm i cili do të ndikojë detyrimisht në efikasitetin e gjykatës respektive dhe aksesin në drejtësi për qytetarët. Situata e mësipërme ilustron më poshtë në formën e grafikut (Grafiku nr. 1).

⁴⁰ Në bazë të kërkesës për informacion të datës 1 prill, dërguar pranë Gjykatës së Lartë, gjykatave të rretheve gjyqësore dhe të apelit, si dhe pranë gjykatave administrative

⁴¹ Backlog është termi që i referohet çështjeve stok, pra të mbartura dhe që pritet të gjykohen.


Duke iu referuar të dhënave statistikore⁴² të vitit 2018, të raportuara nga gjykatat, mbi (i) numrin e çështjeve gjyqësore të regjistruara në vitin 2018 (penale civile), (ii) numrin e çështjeve të mbartura nga viti 2017, (iii) numrin e çështjeve të përfunduara në vitin 2018, (iv) numrin e kërkesave për delegim, (v) numrin e çështjeve të klasifikuara si kërkesa penale apo si kërkesa civile, (vi) kohën e nevojshme për përfundimin e çështjeve⁴³, (vii) koeficientin e shpejtësisë së gjykimit⁴⁴, si dhe, (viii) numrin e çështjeve të mbartura për vitin 2019, rezultojnë treguesit e mëposhtëm:

- i) Në total, gjatë vitit 2018 janë regjistruar 147 423 çështje dhe 68 982 janë mbartur nga 2017. Ndërkohë në fundin e vitit 2018, numri i çështjeve të mbartura është 75 803. Nga të dhënat konstatohet që Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ajo Vlorë dhe Shkodër, për sa i përket gjykatave të shkallës së parë, kanë fluksin më të madh të çështjeve. Nga gjykatat e apelit fluksin kryesor të regjistrimit të çështjeve e ka Gjykata e Apelit Tiranë dhe ajo Vlorë. Ndërsa për sa i përket gjykatave administrative, vihet re që numri më i madh i çështjeve është reregjistruar sërish në Gjykatën e Apelit Tiranë dhe atë të Apelit Administrativ.

Krahasimi mes numrit të çështjeve të mbartura nga viti 2017 në vitin 2018 (68 982) dhe nga viti 2018 në vitin 2019 (75 803) tregon, pavarësisht faktorëve që ndikojnë, që eficientia e gjyqësorit në vitin e fundit (2018) pasqyron përkeqësim (raporti i evadimit të çështjeve është në rendin e 91%) sepse është rritur backlog-u në shkallë vendi, rrjedhimisht edhe koha e nevojshme për trajtimin e çështjeve. Sigurisht si çdo vlerë statistikore, kjo shifër nuk merr në konsideratë të sqarojë apo të hulumtojë mbi arsyet. Për këto të fundit duhet një analizë cilësore për të mbështetur këto të dhëna sasiore duke vlerësuar korelacionin përkatës, si dhe duke shqyrtuar nëse mund të merren masa që të shuajnë apo pakësojnë faktorët ndikues.

Grafiku i mëposhtëm, (Nr. 1) ilustron shpërndarjen e çështjeve sipas gjykatave si dhe peshën e çështjeve të mbartuara nga viti 2017 për secilën gjykatë. Në aksin horizontal është dhënë numri i çështjeve.

Grafiku 1: Nr. çështjeve të regjistruara në vitin 2018 dhe mbartur nga 2017




42 Statistikat e marra dhe të përfshira në këtë analizë nuk kanë qenë të plota dhe në disa raste logjika e zbatuar për formulat ka ndryshime nga njëra gjykatë në tjetrën. Për më tepër nuk është pasur një kohë e mjaftueshme në dispozicion për një analizë të thelluar statistikore.

43 Formula Clearance rate penal/civil (Treguesi Norma e Përfundimit / Likuidimit të Çështjeve)

44 Formula Case Disposition Time penal/civil (Koha e nevojshme për Përfundimin/Likuidimin e Çështjeve)

- ii. Grafiku në vijim (*Grafiku 2*) ilustron numrin e çështjeve të mbartura për çdo gjykatë në dy vitet e fundit: 2018 dhe 2019. Ndërkohë që disa gjykata kanë arritur të ulin numrin e çështjeve stok (backlog) dhe kjo tregon përmirësim të efikasitetit të këtyre gjykatave, gjykata të tjera e kanë rritur numrin e çështjeve të mbartura duke shënuar kështu ulje të efektshmërisë së punës në dy vitet e referimit.

Grafiku 2: Nr. çështjeve të mbartura në vitet 2018 dhe 2019



Të dhënat e dërguara nga gjykatat në lidhje me backlog-un (çështjet e mbartura) paraqiten edhe në formë tabelore:

Tabela 1: çështje të mbartura për çdo gjykatë në vitet 2018 dhe 2019


GJYKATA	ÇËSHTJE TË MBARTURA	ÇËSHTJE TË MBARTURA 2019	NDRYSHIMI NË %
	2018		
Berat	542	715	32
Dibër	194	231	19
Durrës	955	1230	29
Elbasan	1003	1189	19
Fier	1054	1058	0
Gjirokastrë	298	338	13
Kavajë	430	441	3
Korçë	559	724	30
Krujë	362	366	1
Kukës	146	161	10
Kurbin	291	355	22
Lezhë	407	499	23
Lushnje	692	478	-31
Mat	84	142	69
Përmet	42	75	79
Pogradec	300	269	-10
Pukë	73	62	-15
Sarandë	302	281	-7
Shkodër	819	1263	54
Tiranë	6377	6709	5
Tropojë	94	118	26
Vlorë	1463	1312	-10
Shk.I.Kr.R	88	78	-11
Apeli Tiranë	7956	8271	4
Apeli Shkodër	1894	1383	-27
Apeli Durrës	1289	1340	4
Apeli Korçë	365	455	25
Apeli Gjirokastrë	237	250	5
Apeli Vlorë	2712	1878	-31

Apel Kr.R.	40	34	-15
Apel Adm	12661	12217	-4
Adm Tiranë	1155	1064	-8
Adm Shkodër	1083	978	-10
Adm Korçë	398	340	-15
Adm	93	147	58
Gjirokastrë			
Adm Vlorë	524	489	-7
Gjykata e Lartë	22000	28863	31
Totali për të gjithë gjykatat	68982	75803	10

Ashtu siç u theksua më lart, për të bërë një vlerësim të treguesit se sa gjykata të ndryshme janë në gjendje të përballen me fluksin e regjistrimit të çështjeve në zonat e veta të përgjegjësisë, është marrë në shqyrtim ndryshimi i gjendjes së çështjeve të mbartura në vitin 2018 dhe atyre të mbartura në vitin 2019.

Në një paraqitje grafike të ndryshimit të backlog-ut të çështjeve vihet re që disa gjykata e kanë ulur stokun e çështjeve të prapambetura në vitin 2019 në krahasim me vitin 2018. Megjithatë në shkallë vendi vihet një rritje me rreth 10% e stokut të çështjeve të pa trajtuara brenda vitit të regjistrimit fillestar.

Siç vihet re nga ky grafik (Grafiku nr. 3), ka gjykata që e kanë ulur stokun e çështjeve të mbartura në vitin 2019 krahasuar me vitin 2018 si, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnje, Pogradec, Pukë, Gjykata e Apelit Vlorë, etj. Ndërsa gjykata të tjera e kanë rritur këtë tregues si Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat, Dibër, Durrës, Mat, Përmet, Shkodër, etj. Duhet pasur parasysh që ky tregues është dhënë në përqindje, ndryshimet në vlera absolute mund të verifikohen në tabelën Nr. 1.



- iii. Nëse marrim në shqyrtim ecurinë e përfundimit të çështjeve për gjykatë, na paraqitet një pasqyrë (tabela 2) ku mund të shihen ritme të ndryshme të evadimit të çështjeve nga gjykata të ndryshme edhe kur këto gjykata kanë thujse të njëjtën numër gjyqtarësh. Tabela pasqyron të dhënat e deklaruara nga vetë gjykatat pa bërë krahasime matematikore për arsye se karakteristikat e çështjeve, numri i çështjeve për gjyqtar dhe norma individuale e përfundimit të çështjeve për çdo gjyqtar nuk janë të pasqyruara.

Tabela 2

Gjykata	Nr. i gjyqtarëve fakt	Nr. i çështjeve të përfunduara
Berat	9	1452
Dibër	4	752
Durrës	16	6726
Elbasan	12	2583
Fier	14	6887
Gjirokastrë	6	963
Kavajë	4	979
Korçë	12	4826
Krujë	3	2361
Kukës	2	498
Kurbin	4	658
Lezhë	5	1226
Lushnje	4	1236
Mat	4	325
Përmet	4	477
Pogradec	4	1451
Pukë	3	219
Sarandë	6	1075
Shkodër	13	3631
Tiranë	74	33260
Tropojë	3	366
Vlorë	14	2850
Shkalla e Parë për Krimet e Rënda	15	142
Apeli Tiranë	29	7181
Apeli Shkodër	10	1760
Apeli Durrës	10	1377
Apeli Korçë	6	696
Apeli Gjirokastrë	6	882
Apeli Vlorë	10	1856
Apeli për Krimet e Rënda	11	114
Administrative e Apelit	13	5551
Administrative e Shkallës Parë Tiranë	16	7774
Administrative e Shkallës Parë Shkodër	2	1163
Administrative e Shkallës Parë Korçë	2	2393
Administrative e Shkallës Parë Gjirokastrë	2	2299
Administrative e Shkallës Parë Vlorë	4	2308
Gjykata e Lartë	5	1673

4.1.2 Shpejtësia e trajtimit të çështjeve


i) Norma e zgjidhjes së çështjeve (Treguesi CR): Raporti ndërmjet çështjeve të reja dhe çështjeve të përfunduara brenda një periudhe në përqindje.

Treguesi CR ofron një trend të përgjithshëm mbi gjendjen e sistemit gjyqësor për sa i përket ecurisë së sistemit në harkun kohor prej një viti, pra ofron një pasqyrë nëse gjykatat kanë arritur të ruajnë ritmin mes çështjeve të reja të regjistruara dhe atyre të përfunduara. Llogaritja e Treguesit CR bëhet duke pjesëtuar numrin e çështjeve të përfunduara me numrin e çështjeve të reja dhe vlera shumëzohet me 100 për t'u shprehur rezultati në përqindje. Për rastet kur treguesi është nën 100% mund të thuhet që ritmet nuk ka qenë të mundur të ruhen dhe backlog-u i çështjeve është rritur në krahasim me një vit më parë. Në këto raste një analizë e thelluar duhet të shqyrtojë edhe alternativat për zgjidhjen e problematikës në një kohë sa më të shkurtër të mundshme në mënyrë që numri i çështjeve të prapambetura të mos bllokojë sistemin dhe që zgjidhja e çështjeve të bëhet brenda afateve të caktuara në legjislacionin procedural në fuqi ashtu


si dhe tek “Kriteret matëse të veprimtarisë gjyqësore” parashikuar në Sistemin e Vlerësimit të Gjyqtarëve⁴⁵

Treguesi CR, i dhënë në %, sipas nivelit dhe tipologjisë së gjykatave, siç paraqiten më poshtë jep një pasqyrë të ecurisë së zgjidhjeve të çështjeve. Duhet theksuar që grafikët e paraqitur bazohen ekskluzivisht në përllogaritjet e vetë gjykatave që bëjnë me dije vështirësitë në analizën statistikore që ka ardhur si pasojë e mosfunksionimit korrekt të sistemit ICMIC, mungesës së burimeve të mjaftueshme njerëzore dhe arsyeve të tjera të përmendura në fillim të këtij seksioni.

Grafiku 4: Norma e zgjidhjes së çështjeve (Treguesi CR): gjykatat e shkallës së parë




Grafiku 5: Norma e zgjidhjes së çështjeve (Treguesi CR): gjykatat e apelit




⁴⁵ Vendim nr. 261/2, datë 14.04.2010 “Sistemi i Vlerësimit të Gjyqtarëve”

Grafiku 6: Norma e zgjidhjes së çështjeve (Treguesi CR): gjykatat administrative




ii) **Koha e nevojshme për likuidimin e çështjes (Treguesi DT):** Krahason numrin e çështjeve të zgjidhura gjatë periudhës së monitoruar dhe numrin e çështjeve të pazgjidhura në fund të periudhës së monitoruar. Numri i çështjeve në pritje për gjykim pjesëtohet me numrin e çështjeve të zgjidhura dhe shumëzohet me 365 në mënyrë që të mundësohet të shprehurit në numër ditësh. Raporti mat se sa shpejt sistemi gjyqësor i gjykatës punon mbi çështjet e marra, që do të thotë sa kohë duhet për një lloj të caktuar çështjeje për t'u zgjidhur. Ky tregues jep një perceptim se si një sistem gjyqësor menaxhon sasinë apo fluksin e çështjeve.

Treguesi DT⁴⁶ jepet në ditë dhe paraqitet në vijim sipas specifikave të gjykatave dhe të çështjeve:




⁴⁶ Grafiku bazohet vetëm në koeficientët e nxjerrë nga vetë gjykatat.


GRAFIKU 8: KOHA E NEVOJSHME PËR LIKUIDIMIN E ÇËSHITJEVE: DT PENALE, SHKALLA E PARË




GRAFIKU 9: KOHA E NEVOJSHME PËR LIKUIDIMIN E ÇËSHITJEVE: DT CIVILE, APEL



GRAFIKU 10: KOHA E NEVOJSHME PËR LIKUIDIMIN E ÇËSHITJEVE: DT PENALE, APEL



**GRAFIKU 11: KOHA E NEVOJSHME PËR LIKUIDIMIN E ÇËSHTJEVE:
DT ADMINISTRATIVE**



4.1.3 Përdorimi i sistemit audio në gjykata për vitin 2018

Zbatimi i sistemit të regjistrimit digjital audio në gjykata përbën një kërkesë të detyrueshme ligjore, çka garanton saktësi të nivelit të lartë të dokumentimit të seancës gjyqësore dhe rrit transparencën, efikasitetin si dhe përmirëson administrimin e gjykatave. Për më tepër, regjistrimi audio i seancave garanton transparencë dhe efikasitet më të lartë në përdorimin e burimeve të sistemit gjyqësor.

Përdorimi i sistemit audio të regjistrimit të seancave gjyqësore, përbën një investim të rëndësishëm në sistemin gjyqësor në funksion të transparencës dhe efijencës, ku kontribut në këtë drejtim kanë dhënë partnerët tanë. Sipas raportimeve periodike të kryetarëve të gjykatave, në të dhënat për përdorimin e sistemit audio konstatohet se ka gjykata të cilat kanë një përdorim të kënaqshëm të sistemit audio, ndërkohë që ka dhe gjykata, të cilat kanë përdorim të dobët të këtij sistemi. Në total shprehur në % niveli i përdorimit të sistemit audio është 77%.⁴⁷

Këtu, evidentohet Gjykatat e Apelit për Krimet e Rënda e cila ka një përdorim 100% të regjistrimit të seancave gjyqësore, dhe me përdorim të kënaqshëm janë të gjitha gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm në nivel apeli. Ndërkohë që Gjykata Administrative e Apelit ka një përdorim të sistemit në 42%.

Në gjykatat e shkallës së parë konstatohet se përdorim të kënaqshëm ka gjykata e Gjirokastrës, Dibërës, Korçës, Kukësit, Pogradecit, Pukës, Sarandës, Lezhës, Përmetit, Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda dhe Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë. Ndërkohë që gjykatat administrative të shkallës së parë Durrës, Gjirokastrër dhe Shkodër, ashtu si dhe gjykatat e rretheve gjyqësore Durrës, Kurbin, Shkodër, kanë një përdorim nën mesataren e përgjithshme të përdorimit të tij për vitin 2018.


Duhet një analizë e thelluar për të evidentuar arsyet e mospërdorimit të sistemit audio, për të vlerësuar se pse në shumë gjykata, që kanë volum të ulët me çështje, apo në gjykata me numër të vogël gjyqtarësh, kanë një përdorim të lartë të sistemit audio dhe kjo nuk ka të njëjtin trend, përdorim, edhe në gjykatat e tjera me të njëjtat kushte.

Vlerësohet që të vijohet me raportimet në këtë drejtim nga gjykatat në drejtim të KLGJ, në mënyrë që të analizohet ecuria e përdorimit të këtij sistemi, i cili i shërben më së

⁴⁷ Sa i përket seancave audio të paregjistruara, shumica e tyre janë "Urdhër ekzekutimi" që mbahen në dhomat e këshillimit. Sistemi që prodhon këto të dhëna statistikore (PAKS+) përfshin tabelën përmbledhëse, duke përfshirë sesionet e mbajtura në dhomën e konsultimit jo audio, duke bërë kështu përqindjen e përdorimit të sistemit audio më të vogël se sa reale.

mirë pasjes së një sistemi gjyqësor transparent, evidentimit të përdorimit të tij, evidentimit të gjyqtarëve të cilat hezitojnë dhe nuk e përdorin këtë sistem kur gjykata e ofron këtë mundësi.

Nga të dhënat e gjykatave për vitin 2018 përfitohet pasqyra grafike e mëposhtme:



4.1.4 Vonesat në dorëzimin e vendimeve gjyqësore të arsyetuara

Mos arsyetimi i vendimeve brenda afateve të arsyeshme bie në kundërshtim me ligjin procedural dhe cenon të drejtën kushtetuese të të gjykuarit për ankim dhe akses në gjykatë. Për më tepër, shpallja e vendimit përfundimtar të arsyetuar është detyrim ligjor me pasojë pavlefshmërinë e tij. Arsyetimi ligjor i vendimit është një element i rëndësishëm i procesit të rregullt ligjor i cili ka për qëllim: a) ushtrimin e kontrollit gjyqësor nga një gjykatë më e lartë dhe b) ushtrimin e kontrollit publik në administrimin e drejtësisë. Të dy këta elementë lidhen ngushtësisht me të drejtën e ankimit të subjektit procedural pasi kontrolli gjyqësor nuk ushtrohet në mënyrë incidentale, por mbi bazën e shkaqeve të ngritura nga palët në proces. Kufizimi në kohë i së drejtës së ankimit lidhet me përcaktimin jo vetëm të detyrimit të gjykatës për ta arsyetuar vendimin përfundimtar por edhe dorëzimin e vendimit në sekretarinë gjyqësore.

Arsyetimit të vendimeve gjyqësore i është kushtuar rëndësi si një detyrim më së pari kushtetues, i përcaktuar shprehimisht në nenin 142 të Kushtetutës, por dhe i plotësuar nga legjislacioni procedural gjyqësor, i cili vendos afate strikte për arsyetimin e vendimeve gjyqësore, kjo për arsye se i) arsyetimi i vendimit përbën një ndër të drejtat themelore të njeriut; ii) mbi bazën e një vendimi të arsyetuar ushtrohet kontrolli ndaj tij, nëpërmjet të drejtës së ankimit gjyqësor.

Arsyetimi i vendimit gjyqësor ka të bëjë me cilësinë e drejtësisë, e theksuar kjo edhe në Raportet e Progresit të BE-së ku në analizën që i bëhet vendit tonë theksohet se: "...vendimet gjyqësore shpesh kanë mungesa të arsyetimit të duhur dhe afatet e publikimit të tyre nuk respektohen gjithmonë. Ka nevojë për përpjekje për të përmirësuar aftësitë e gjyqtarëve për arsyetimin e vendimeve".

Në lidhje me arsyetimin në kohë të vendimeve gjyqësore, jemi bazuar në mekanizmin e raportimit periodik të kryetarëve lidhur me respektimin e afatit të dorëzimit në kohë të vendimeve në sekretarinë gjyqësore. Nga këto të dhëna shikohet se kryetarët e

gjykatave e kanë respektuar detyrimin për të dhënë informacion mbi këtë proces. Në vëmendje janë mbajtur të gjitha rastet e vonuara mbi 30 ditë të arsyetimit të vendimit të konstatuara nga kryetarët e gjykatave në raportet e tyre.

Nga të dhënat e raportuara, për rastet e vonuara të arsyetimit të vendimeve, për gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm, konstatohen se për vitin 2018 kemi të raportuara nga kryetarët e gjykatave gjithsej 671 raste, nga të cilat, 305 në gjykatat e nivelit të parë dhe 366 raste në nivel apeli me juridiksion të përgjithshëm. Evidentohet se gjykata me numrin më të madh të arsyetimit me vonesë është Gjykata e Apelit Vlorë me 332 raste, për të vijuar më pas me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë, me 161 raste, pasuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me 83 raste.

Ndërkohë në gjykatat administrative konstatohet në total 547 raste të arsyetimit me vonesë të vendimeve gjyqësore. Me numrin më të madh në këto gjykata shfaqet Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë me 407 raste vonesash, pasur nga Gjykata Administrative e Apelit me 106 raste.

Nga vlerësimi i problematikave të raportuara nga gjykatat evidentohet se vonesat në arsyetimin e vendimeve ndikohen nga ngarkesa në numër çështjesh që kanë gjyqtarët, numri i vogël i gjyqtarëve në gjykata, lejet e marra për arsye të ndryshme që mund të kenë pasur gjyqtarët, efektet e procesit të vettingut etj. Problematike nga këto të dhëna, në vitin 2018, mbetet Gjykatat e Apelit Vlorë dhe Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë të cilat krahasuar me gjykatat ekuivalente në numër gjyqtarësh kanë shfaqur një numër të lartë vonesash në arsyetimin e vendimeve. Një konstatim gjithëpërfshirës nga raportimet është se numri i vogël i gjyqtarëve në gjykata të cilat kanë volum të madh çështjesh gjyqësore ndikon në vonesën e arsyetimit të vendimeve gjyqësore në kohë. Emërimi i ndihmësve ligjorë dhe stafit tjetër ndihmës në gjykata me volum të madh çështjet duhet marrë në konsideratë si një faktor i rëndësishëm për përgatitjen e dosjes gjyqësore dhe për pasojë rritjen e shpejtësisë në evadimin e çështjeve.

Raportimi i këtyre të dhënave duhet të vijojë të kërkohet kryetarëve të gjykatave. Analizimi i tyre do të bëjë që të evidentohen shkaqet për sa më sipër. Nëse konstatohet se vonesa në arsyetimin e vendimit është për shkak të veprimtarisë së gjyqtarit, atëherë mbahet në konsideratë në vlerësimin e veprimtarisë së tij/saj profesionale dhe etike. Nëse shkelja nuk është për faj të gjyqtarit por për shkaqe të tjera KLGJ duhet të ndër marrë hapat e duhur për të ndërhyrë dhe për të lehtësuar ato gjykata që gjenden në vështirësi.

Në vlerësim të rëndësishëm të kësaj problematike KLGJ në mbledhjen 07.02.2019 vendosi të vijojë më kërkesën e informacionit periodik nga kryetarët e gjykatave në lidhje me: *ngarkesën e çështjeve gjyqësore, respektimin e etikës dhe solemnitetit, numrin e kërkesave për heqje dorë të miratuara nga kryetari i gjykatës, funksionimin e sistemit të regjistrimit audio dhe nivelin e përdorimit të tij, gjendjen e përdorimit dhe funksionimit të sistemit të menaxhimit të çështjeve, problematika të shfaqura në lidhje me vonesat në dorëzimin e vendimeve të arsyetuara, etj.*

Gjithashtu është detyrë e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë i cili është përgjegjës për vlerësimin e ankesave, fillimin e hetimeve lidhur me shkeljet dhe iniciimin e procedurave disiplinore në lidhje me gjyqtarët e të gjitha niveleve, për të vijuar me inspektimet e ndryshme për arsyetimin në kohë të vendimeve gjyqësore. Në rastet kur konstaton përsëritje për shkak të veprimtarisë së gjyqtarit ky organ është kompetent të bëjë hetimet e duhura disiplinore.

Nga evidentimi i rasteve të dorëzimit me vonesë të vendimeve gjyqësore të arsyetuara për viti 2018 rezulton pasqyra e mëposhtme:

1. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë: 1 rast;
2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës: 7 raste;
3. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë: 12 raste;
4. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnje: 161 raste;
5. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat: 2 raste;
6. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec: 5 raste;
7. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër: 26 raste;
8. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë: 83 raste;
9. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë: 1 rast;
10. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë: 7 raste;
11. Gjykata e Shkalles së Parë për Krimet e Rënda: 1 rast;
12. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë: 35 raste;
13. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë: 407 raste;
14. Gjykata e Apelit Korçë: 10 raste;
15. Gjykata e Apelit Tiranë: 20 raste;
16. Gjykata e Apelit Vlorë: 332 raste;
17. Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda: 4 raste;
18. Gjykata Administrative e Apelit: 106 raste.

4.1.5 Efekti i ndryshimeve në legjislacion

Ndryshimet që ka pasur legjislacioni i vendit tonë gjatë viteve 2017–2018 ka ndikuar edhe në veprimtarinë e gjykatave, sidomos ato ligje që kanë hyrë në fuqi në fund të vitit 2017 por zbatimin e kanë pasur në vitin 2018. Adaptimi me norma dhe procedura të reja apo të ndryshuara kërkon kohën e vet të asimilimit dhe kjo ka sjellë edhe një ulje të ritmit të trajtimit të çështjeve dhe rrjedhimisht të performancës në gjykata.

Konkretisht ndryshim ka pësuar Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë i miratuar me ligjin nr.35/2017, i cili solli ndryshime në të drejtat e viktimës së veprës penale, në sigurimin e të drejtave dhe mbrojtjen e të pandehurit në procedurat penale; përmirësimin e normave të gjyqësorëve të shkurtuara dhe të gjykimin të drejtpërdrejtë.

Ndryshimet e Kodit Penal u bënë me ligjin nr.36/2017, duke synuar shpejtësi në rehabilitimin për shkelësit më pak të rrezikshëm në vend të burgimit, në mënyrë që të kontribuojnë në uljen e numrit të të burgosurve dhe për të lidhur dispozitat e Kodit Penal në fuqi më shërbimin e provës për lirim në më të hershëm me kusht të njerëzve.

Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur, miratuar me ligjin nr.37/2017, hedh themelet për një drejtësi penale për të mitur në përputhje me Kushtetutën, duke pasur për qëllim mbrojtjen e të miturit dhe mbrojtjen efektive të interesit më të lartë të të miturit. Ky kod përmban rregullime të posaçme lidhur me përgjegjësinë penale të të miturve, rregulla procedurale lidhur me hetimin, ndjekjen penale, procesin gjyqësor, ekzekutimin e vendimit të dënimit penal, rehabilitimin ose të çdo mase tjetër që përfshin një të mitur në konflikt me ligjin, si dhe një të mitur viktimë dhe/ose dëshmitar të veprës penale. Rregullimet e parashikuara janë edhe për të rinjtë nga grup-mosha 18 deri në 21 vjeç, sipas parashikimeve në nene të veçanta të tij.

Kodi i procedurës civile u amendua me ligjin nr.38/2017, datë 30.3.2017 duke sjellë efikasitet dhe procedura me të shpejta, efikase, shkurtim të kohëzgjatjes dhe numrit të seancave të proceseve civile; rritje e aksesit të qytetarëve të sistemi i drejtësisë.

Të gjitha këto ndryshime në kodet procedurale kanë rritur rolin e përfshirjes së gjykatës dhe të investimit të gjyqtarit në veprimet procedurale të një çështje gjyqësore. Për gjyqtarin e seksionit penal tanimë është shtuar si kompetencë vlerësimi i gjendjes së të


pandehurit që në fazën fillestare të hetimeve paraprake, ndërkohë që më parë kjo kompetencë i përkiste prokurorit. Gjyqtari penal tanimë shqyrton masat e sigurimit dhe çdo kërkesë tjetër që i paraqitet gjatë fazës së hetimeve paraprake, kërkesat në seancë me objekt dërgimin e çështjeve për gjykim apo miratimin e urdhrin penal. Ndërsa ndryshimet në Kodin e Procedurës Civile kanë sjellë që gjyqtari në fazat paraprake të investohet në përgatitjen e dosjes gjyqësore edhe mbledhjen e të gjitha provave përpara caktimit të seancës, përmirësimin e procesit të njoftimeve, masa që në fakt sjellin më tepër saktësi dhe efikasitet të procesit gjyqësor. Ndryshimet e legjislacionit në fuqi dhe ndërhyrja me mekanizma procedural paraqesin vështirësi aplikimi në fazën fillestare, duke ndikuar disi në uljen e ritmit të trajtimit të çështjes.

4.1.6 Analiza mbi situatën në Gjykatën e Lartë

Reforma në Drejtësi solli ndryshime radikale edhe në lidhje me Gjykatën e Lartë. Nisur nga problematikat e konstatuara ndër vite reforma synoi që ta bënte këtë gjykatë pjesë të sistemit gjyqësor duke e bërë një gjykatë karriere dhe duke përcaktuar qartë kriteret për të qenë anëtar i saj, si për gjyqtarët e karrierës ashtu dhe ato që vijnë nga jashtë sistemit.

Aktualisht Gjykata e Lartë është pjesë e sistemit gjyqësor nën drejtimin e KLGJ dhe kompetente për shqyrtimin e çështjeve të cilat lidhen me kuptimin dhe zbatimin e ligjit, me qëllim që të sigurohet unifikimi, konsistenca dhe zhvillimi i praktikës gjyqësore. Ndaj, në zbatim të parashikimeve kushtetuese⁴⁸ është e rëndësishme të përcaktohet lloji i çështjeve që pranon kjo gjykatë duke sjellë standarde për unifikimin, sigurinë dhe/ose zhvillimin e jurisprudencës dhe jo të një gjykate të shkallës së tretë.

Nga informacioni i ardhur nga Gjykata e Lartë, në kushtet e funksionimit të saj efektivisht vetëm me 3 anëtarë nga 19 anëtarë, konstatohet se në fund të vitit 2017 numri i çështjeve të mbartura ishte 22 000, ndërsa në fund të vitit 2018 ky numër ishte 28 863, vit në të cilin u arrit të zgjidhen 1673 çështje me një mesatare prej 279 çështje për gjyqtar. Matematikisht rezulton që Gjykata e Lartë ka përdorur vetëm 20 ditë për përfundimin e një çështjeje që përbën edhe kohën më të ulët në rang vendi ku mesatarja është 64 ditë.



⁴⁸ "Neni 141 - 1. Gjykata e Lartë shqyrton çështje lidhur me kuptimin dhe zbatimin e ligjit për të siguruar njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore, sipas ligjit. 2. Për ndryshimin e praktikës gjyqësore, Gjykata e Lartë tërheq për shqyrtim në Kolegjet e Bashkuara çështje të caktuara gjyqësore të vendosura nga kolegjet, sipas ligjit."

Për efekt statistikor mund të thuhet që zgjidhja e të gjitha çështjeve të mbetura, bazuar në këto ritme, do të kërkonte 6297 ditë ose 17 vjet e 3 muaj. Aktualisht raportohet të jenë rreth 31 000 mijë dosje në prite për t'u gjykuar në Gjykatën e Lartë.

4.1.7 *Përmbledhje e analizës statistikore*

Nga një vështrim i shpejtë mbi statistikën dhe treguesit e sistemit gjyqësor në Shqipëri, e parë ngushtë në lidhje me ecurinë e procesit të reformës në drejtësi, mund të thuhet që pavarësisht pengesave dhe vështirësive, sistemi gjyqësor paraqet një panoramë mikse:

1. ulja e efijencës në trajtimin e çështjeve, e matur me një rritje prej rreth 10% të backlog-ut nga viti 2018 në vitin 2019, i atribuohet në një masë të konsiderueshme bllokimit të Gjykatës së Lartë, ku zgjidhja e ngërçit do të rrisë edhe performancën e gjyqësorit në kontekstin e trajtimit në kohë të çështjeve.

2. Mungesa në numrin efektiv të gjyqtarëve pranë çdo gjykate, e rrahasuar kjo edhe me mesataren evropiane (13.5 vs 18) tregon që ka vend të shqyrtohet numri total i magistratëve që ushtrojnë detyrën dhe që sigurisht do të rriste efektshmërinë e ofrimit të drejtësisë.

3. Rritja e efijencës së sistemit gjyqësor është ndër objektivat primare të reformës në drejtësi. E parë në këtë kontekst, dhe duke marrë parasysh që një numër gjykatash nuk e kanë pasur të mundur të ndjekin ritmin e evadimit të çështjeve, rishikimi i hartës gjyqësore është një element i domosdoshëm dhe urgjent me synimin për të rritur efijencën e përgjithshme të sistemit gjyqësor. Edhe më urgjente bëhet kjo masë në kontekstin e numrit relativisht të lartë të magistratëve të pakonfirmuar në detyrë si rrjedhojë e vettingut.

4. Dy treguesit CEPEJ, shpejtësia e trajtimit të çështjeve dhe koha e nevojshme për mbylljen e një çështjeje tregon disbalanca të konsiderueshme mes gjykatave. Kjo do të thotë që në shumicën e gjykatave të të gjitha shkallëve ka ende hapësirë për përmirësimin e efijencës.

5. Problemet me infrastrukturën e gjykatave dhe sidomos me sistemet elektronike të menaxhimit të çështjeve krijojnë jo pak vështirësi në menaxhimin e punës dhe ngarkesës në gjykata. Zgjidhja e këtyre problemeve përbën prioritet për periudhën në vazhdim.

6. Ndryshimet e mëdha në fushën e legjislacionit, edhe në kuadër të përafrimit të legjislacionit me *Acquis* të BE-së, kërkojnë organizimin e një numri të konsiderueshëm trajnimesh intensive dhe specifike për kategoritë e magistratëve. Por ky hap nuk mund të ndërmerret pa analizuar paraprakisht nevojat për trajnime në shkallë vendi dhe planifikimin e tyre për një periudhë deri në njëvjeçare. Për këtë, analiza e nevojës për trajnime konsiderohet si një tjetër prioritet.

7. Bazuar në të dhënat e publikuara nga CEPEJ për vitin 2016⁴⁹ dhe duke marrë në konsideratë një krahasim me vende të rajonit si Maqedonia e Veriut dhe Serbia, na shfaqet tabloja e mëposhtme, që me përjashtim të treguesve aktualë të Gjykatës së Lartë, tregon që për gjyqësorin shqiptar është plotësisht e mundur që të arrihen pjesa më e madhe e standardeve evropiane. Në tabelën në vijim janë evidentuar me të kuqe treguesit larg mesatares evropiane, me të gjelbër ato tregues që janë më mirë se mesatarja evropiane dhe me të verdhë treguesit që mund të arrihen në një periudhë afatshkurtër:

⁴⁹ https://public.tableau.com/profile/cepej#!/vizhome/CEPEJ-Overviewv3_0/Overview

INDIKATORI	Maqedonia e Veriut	Serbia	Shqipëria 2016	Shqipëria 2018 ⁵⁰	Mesatarja Evropiane
Gjyqtarë për 100 000 banorë	27.3	38.5	12.6	13.5	18
CR civile shkalla e parë	190.3%	93.9%	99%	91%	99.6%
DT civile shkalla e parë	446 ditë	315 ditë	159 ditë	86 ditë	196 ditë
CR penale shkalla e parë	252%	103.4%	99.9%	90%	101.2%
DT penale shkalla e parë	342 ditë	274 ditë	108 ditë	83 ditë	118 ditë
CR administrative shkalla e parë	187.8%	89.4%	97.9%	119%	99.7%
DT administrative shkalla e parë	740 ditë	539 ditë	115 ditë	154 ditë	242 ditë
CR penale shkalla e dytë	196.8%	100.2%	76.7%	113%	99.8%
DT penale shkalla e dytë	206 ditë	23 ditë	413 ditë	145 ditë	80 ditë
CR shkalla e tretë	188.8%	96.1%	100.7%	21.4%	99.7%
DT shkalla e tretë	466 ditë	63 ditë	253 ditë	6297 ditë	107 ditë

4.2 VEPRIMTARIA E ZYRËS SË ADMINISTRIMIT TË BUXHETIT GJYQËSOR (ZABGJ)

Ish-Zyra e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor (ZABGJ), ka ushtruar aktivitetin e saj në bazë dhe në përputhje me Ligjin nr. 8363, datë 01.07.1998 “Për krijimin e Zyrës së Administrimit të Buxhetit Gjyqësor”.

ZABGJ-ja, si Njësi Publike, ka menaxhuar aktivitetin financiar dhe buxhetor të 38 gjykatave të vendit si edhe të vetë Zyrës.

Misioni i ZABGJ-së ka qenë menaxhimi me efektivitet dhe efikasitet i fondeve buxhetore të akorduara për pushtetin gjyqësor.

Fondet buxhetore të pushtetit gjyqësor janë pjesë e buxhetit të shtetit që miratohet çdo vit me ligjin e buxhetit. Të dhënat për buxhetet dhe numrin e punonjësve të miratuar në 5 vitet e fundit për gjyqësorin paraqiten në tabelën e mëposhtme (të dhënat e vitit 2020 janë tavanet e miratuara për Projekt-Buxhetin Afatmesëm 2020-2022, me VKM nr.117, datë 13.03.2019)

Tabela nr. 1 - Të dhëna për buxhetet në vite për Pushtetin Gjyqësor

000 leke				
Përshkrimi	2017	2018	2019	Tavanet 2020
Shpenzime Korrente	2,018,000	2,140,000	2,220,150	2,973,150
Shpenzime Kapitale	170,000	160,700	160,000	200,000
Buxheti total	2,188,000	2,300,700	2,380,150	3,173,150

⁵⁰ Ashtu siç u përmend edhe më lart, këto tregues janë llogaritur në bazë të statistikave të dërguara së fundmi nga gjykatat, të cilat theksojnë se në kushtet e mos-funksionimit të sistemeve IT, saktësia e të dhënave lë për të dëshiruar.

Ndryshimi në % i buxhetit total	-3%	5%	3%	33%
Nr. total i punonjësve miratuar me ligj	1,364	1,369	1,389	
Shpenzime totale te buxhetit te shtetit	467,599,000	497,069,000	519,577,000	
Raporti në % i buxhetit të gjykatave me buxhetin e shtetit	0.47%	0.46%	0.46%	

Sikurse shihet, buxheti i akorduar ka pak rritje, e cila nëse e shohim strukturën buxhetore ka qenë kryesisht për shpenzimet e personelit. Shpenzimet për investime, të cilat sigurojnë përmirësimet cilësorë të sistemit gjyqësor dhe arritjen e synimeve për një shërbim eficient, transparent e të shpejtë për publikun, nuk janë rritur prej disa vitesh, madje në ndonjë rast edhe janë ulur.

Përqindja që zë buxheti i gjyqësorit kundrejt buxhetit të shtetit është mesatarisht 0.46%.

Në raportin e Komisionit Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ), të publikuar në muajin mars 2018, vihet re se Shqipëria vazhdon të ketë nivelin më të ulët të buxhetit të alokuar për gjykatat, krahasuar me vendet e rajonit. Referuar raportit, rezulton se në Shqipëri, ky buxhet është 6 euro/banorë, kur në disa nga vendet e rajonit është: Maqedonia 14 euro/banorë, Bosnja dhe Hercegovina 25 euro/banorë, Mali i Zi 45 euro/banorë, Kroacia 40 euro/banorë. (raporti i CEPEJ 2018, f. 42). Mesatarja e këtij treguesi për vendet evropiane të marra në analizë nga CEPEJ-i është 39 euro/banorë.

Sikurse shihet disa nga vendet e Rajonit kanë një buxhet /banor, më të lartë se sa mesatarja evropiane dhe kjo për faktin se; ndërsa shumica e vendeve evropiane që bëjnë pjesë në BE, kanë arritur standardin e dëshiruar në sistemin e drejtësisë dhe investimi në sistem shkon kryesisht për ruajtjen e standardeve, pa lënë pas zhvillimet për përmirësim të mëtejshëm, vendet e Rajonit të Ballkanit, të cilat aspirojnë për tu bërë pjesë e BE, u duhet të investojnë shumë më tepër edhe se mesatarja evropiane me qëllim arritjen e standardeve të vendeve të BE.

Buxheti i Pushtetit Gjyqësor përbëhet nga shpenzimet korrente (shpenzime personeli, shpenzime operative) dhe nga shpenzimet kapitale.

4.2.1 Në shpenzime personeli.

Buxhetet e alokuara ndër vite kanë mbuluar nevojat për strukturat organike të miratuara me ligj.

4.2.2 Në shpenzime operative

Buxhetet e alokuara kanë qenë vazhdimisht të pamjaftueshme për mbështetjen e plotë të aktivitetit vjetor të gjykatave. Mungesat e buxheteve në këto shpenzime janë plotësuar me rialokimet e bëra çdo vit, me miratim të Ministrisë së Financave. Gjatë negociatave të Programi Buxhetor Afat-mesëm së vitin e kaluar u dakordësua me Ministrinë e Financave që fondet në shpenzime operative për vitin 2019 të ishin minimalisht në nivelin e shpenzimit faktik të vitit 2018 (me qëllim që gjykatave t'u

garantohet i plotë buxheti për shpenzime operationale që në fillim të vitit). Viti 2019 do të jetë edhe viti bazë mbi të cilin do të përlloragriten treguesit e PBA-së 2020-2022, në fazën strategjike që është në proces.

4.2.3 Në shpenzimet kapitale

Buxhetet e alokuara ndër vite kanë qenë të kufizuara. Në një vlerësim të përgjithshëm të investimeve të realizuara deri më sot, rezulton se nga 38 gjykata të vendit, në 22 prej tyre është investuar në ndërtimin e godinave të reja apo rikonstruksionin e plotë të godinave ekzistuese, duke përmirësuar ndjeshëm kushtet e punës, gjykimit e shërbimit që kryhet në to. Konkretisht:

- Janë ndërtuar godina të reja për 9 gjykata⁵¹;
- Janë kryer rikonstruksione për 13 gjykata⁵²;

Në këto godina gjyqtarët dhe stafi administrativ mbështetës kanë sipërfaqe të mjaftueshme pune e janë të vendosur në mënyrë të tillë që lehtësojnë komunikimin e punën e përditshme.

Zona e shërbimit të publikut është e veçantë dhe garanton të gjitha premisat për shërbim cilësor, të shpejtë e transparent. Kjo vendosje nga ana tjetër, është në mbështetje të normave të sigurisë, duke shmangur kontaktet e panevojshme me zonat e tjera të godinës, ku zhvillohen gjyqet, apo ku janë vendosur zyrat e gjyqtarëve. Futja e konceptit të katit të nëndheshëm për hyrjen e të pandehurve në dhomat e izolimit e më tej në sallat penale, është gjithashtu në mbështetje të elementëve të sigurisë. Në godinat e reja janë aplikuar skema të brendshme funksionale të përshtatshme, në përmbushje të standardeve të punës dhe të sigurisë. Gjithashtu në to garantohet aksesimi për personat me aftësi të kufizuara (PAK).

Buxheti i alokuar për vitin 2018 në investime është 160 milion lekë. Referuar objektivave strategjike të përcaktuara në Strategjinë Ndërsektoriale të Sistemit të Drejtësisë dhe studimeve e analizave të kryera nga Zyra, nevojat për investime në gjyqësor janë rreth 3 herë më të larta se ky buxhet.

Duke synuar arritjen e një niveli të njëjtë standardesh në të gjitha godinat e gjykatave, mbetet e domosdoshme ndërhyrja në **16 gjykata të tjera**⁵³.

Duke qenë se buxhetet që nevojiten për ndërtimin janë në vlera të konsiderueshme (në total rreth 29 milion euro), realizimi i tyre është prezantuar të financohet me fonde të tjera.

Investimet e pjeshme të kryera ndër vite në këto godina nuk kanë zgjidhur përfundimisht problemet që paraqesin. Pjesë e këtij grupi, janë edhe gjykatat e rretheve gjyqësore Berat, Fier, Përmet, Tropojë dhe Kukës.

⁵¹ Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat; Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë; Gjykata e Apelit dhe Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, Gjykata e Apelit Korçë, Gjykata e Apelit Vlorë, Gjykata e Rrethit Korçë, Gjykata e Apelit Shkodër dhe Gjykata e Rrethit Elbasan.

⁵² Gjykatat e Apeleve Durrës dhe Gjirokastrë; Gjykatat e Rretheve Dibër, Krujë, Laç, Lezhë, Lushnjë, Pogradec, Pukë, Sarandë, Vlorë ; Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe Gj. Administrative të Apelit Tiranë.

⁵³ Gjykata e Lartë, Gjykata e Apelit Tiranë, Gjykata e Rrethit Berat, Gjykata e Rrethit Durrës, Gjykata e Rrethit Fier, Gjykata e Rrethit Gjirokastrë, Gjykata e Rrethit Kukës, Gjykata e Rrethit Përmet, Gjykata e Rrethit Shkodër, Gjykata e Rrethit Tropojë, Gjykata e Rrethit Tiranë, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastrë, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Korçë, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër.

Gjithashtu nevoja për investime paraqesin edhe Gjykatat Administrative, të cilat kanë nisur veprimtarinë në Nëntor 2013. Për shkak të emergjencës për funksionimin e tyre, akomodimi i gjykatave administrative të shkallës së parë u bë kryesisht në godinat respektive të rretheve gjyqësore. Për rrjedhojë, disa prej këtyre gjykatave paraqesin probleme lidhur me mungesën e ambienteve të nevojshme të punës, si salla gjyqi, zyra etj. Më problematike paraqitet situata për Gjykatat Administrative të Shkallës së Parë Durrës, Gjirokastrë dhe Vlorë.

Për të gjitha këto nevoja është hartuar një plan ndërhyrjesh ndërtimore për përmirësimin infrastrukturor të gjykatave, e cila tregon se nevojat buxhetore për investime në vitet në vijim janë rreth 3 herë më të mëdha se ato të akorduara në vitin 2018 e 2019.

Me miratimin e hartës së re gjyqësore, riorganizimin e gjykatave si edhe në përputhje me planin strategjik të KLGJ-së dhe objektivat e SNSD –së do të përditësohet plani strategjik për infrastrukturën ndërtimore.

4.2.4 Nevojat për sisteme të reja TIK në të ardhmen sipas standardeve ndërkombëtare

Në gjykata aktualisht funksionojnë dy sisteme elektronike për menaxhimin e çështjeve; ARK-IT dhe ICMIS.

Nëpërmjet sistemit elektronik në gjykatë do të duhej të realizohej përpunimi i plotë i paraqitjes së kërkesë padisë që nga regjistrimi i çështjes, hedhja e shortit, mbajtja e procesverbalit, publikimi i vendimit në portalin e të gjithë gjykatave. Gjithashtu sistemi duhet të mundësojë që çështjet të kërkojnë dhe shikohen në Gjykatat e Rretheve Gjyqësore edhe pasi të kenë kaluar në Gjykatat e Apelit dhe Gjykatën e Lartë, të garantojë siguri si dhe gjenerimin e statistikave. Vetëm në këtë mënyrë sistemi i menaxhimit të çështjeve do të ketë efekt të dukshëm në eficienten, transparencën, saktësinë, lehtësimin e përdoruesve të gjykatës, marrjen e vendimeve të drejta duke përdorur statistikën që prodhon sistemi, etj.

Të dy sistemet që janë të instaluar në gjykata kanë mangësi të natyrave të ndryshme dhe tashmë janë kthyer në pengesë të punës në gjykatë. Gjykatat kryejnë punë dyfishe (pra mbajnë një sërë të dhënash në mënyrë manuale) pasi sistemi nuk jua garanton plotësimin e të gjitha nevojave. Vendosija e një sistemi të ri elektronik për menaxhimin e çështjeve gjyqësore, sipas standardeve ndërkombëtare dhe që të ndihmojë procesin e administrimit të dokumentave gjyqësore dhe të procesit gjyqësor, është emergjente.

➤ Problematikat që paraqet sistemi aktual ICMIS

Ky sistem i instaluar në të gjithë gjykatat në vend, paraqet një sërë problemesh, siç mund të jenë:

- Sistemi aktual nuk gjeneron statistika për numrin e çështjeve dhe llojet / specifikat e tyre. Për rrjedhojë, gjykatat i gjenerojnë statistikën në mënyrë manuale dhe ky proces kërkon më tepër kohë për shfletimin e regjistrave fizikë dhe shpesh ka edhe pasaktësi;
- Nuk ka funksionalitetin e lidhjes elektronike me sistemin online të prokurorisë, sistemin e regjistrimit kombëtar elektronik të gjendjes civile, sistemin e Zyrës Rajonale të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, sistemin e përmbarimit;
- Nuk është i përshtatur me ndryshimet e reja të Kodit të Procedurës Penale (duke përfshirë në mënyrë automatike gjyqtarët që kanë shqyrtuar kërkesat gjatë fazës së hetimeve paraprake dhe gjyqtarët e seancave paraprake);

- Nuk realizon komunikimin në kohë reale ndërmjet palëve të ndryshme (sekretarja e regjistrimit, ndihmësit ligjorë) në sistem me atë të njoftimeve me afate kohore në varësi të përparësisë të shqyrtimit të çështjeve për të ndërvepruar;
- Plotësimi i trupit gjykues me gjyqtarë relator, nuk mundësohet në sistem në mënyrë të drejtpërdrejtë (pra nuk ka opsionin për të shtuar një gjyqtar relator të çështjes në sistem);
- Sistemi nuk kategorizon paditë që regjistrohen në gjykatën administrative;
- Vendimet që publikohen në portalin gjykata.gov.al, nuk anonimizohen;

Sistemi duhet përditësuar me teknologji të reja me të. Sistemi ICMIS funksionon vetëm me shfletuesin e internetit (Internet Explorer 8) por jo në versionet më të fundit, që janë të instaluar në kompjuterët dhe serverët në gjykata. Kjo sjell problem pasi pajisjet e reja kompjuterike dhe serverët e gjykatave, nuk e suportojnë instalimin e këtij versioni të internetit (Explorer 8).

Dispozitat të ligjit nr.115/2016, neni 277, parashikojnë transferimin e kompetencave dhe kontratave në lidhje me sistemet e teknologjisë së informacionit duke përfshirë atë të menaxhimit të çështjeve gjyqësore (ICMIS dhe ARKIT) dhe Sistemin Digjital Audio të gjykatave. Për këtë të fundit është nxjerrë Urdhri i përbashkët i Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Ministrisë së Drejtësisë “Për transferimin pa pagesë të aktiveve, të sistemit të menaxhimit të çështjeve të gjyqësorit (ICMIS), nga MD-ja në KLGJ”. Ndonëse ligji parashikon afatin njëmuor për transferimin e sa më sipër, ky proces nuk ka përfunduar ende dhe paraqet disa vështirësi si, mungesa e buxhetit nga ana e KLGJ për rinovimin e kontratës së mirëmbajtjes për sistemin ICMIS, ndërkohë që MD aktualisht nuk mund të kryejë procedura prokurimi për shkak se kjo kompetencë i ka kaluar tashmë KLGJ-së.

Gjithashtu nevojë tjetër prioritare në drejtim të sistemeve TIK, është edhe ndërtimi i një sistemi për informatizimin e arkivës gjyqësore.

Tavani i miratuar në shpenzime kapitale për vitin 2020 është i papërfillshëm në raport me nevojat e sistemit gjyqësor për investime, dhe kjo do të jetë pjesë e diskutimit me Ministrinë e Financave në procesin e hartimit të P/Buxhetit afatmesëm 2020-2022.

4.2.5 Situata e burimeve njerëzore në gjykata

Indikatorët e performancës së gjyqësorit lidhen ndër të tjera edhe me burimet njerëzore dhe sidomos me plotësimin e vendeve vakante në trupën e gjyqtarëve. Evidentimi i burimeve njerëzore në gjykata kërkon krijimin e një database të plotë në rang kombëtar ku të evidentohen karakteristikat profesionale të çdo gjyqtari, si edhe të bëhet e mundur që analizat statistikore të shërbejnë si bazë për reformime të ndryshme.

Nga të dhënat që disponon Sektori i Burimeve Njerëzore, pranë KLGJ-së, gjendja e organikave të gjykatave e të gjitha niveleve është si më poshtë;

Bazuar në Dekretin nr.7818, datë 16.11.2012 “Përcaktimin e numrit të gjyqtarëve për çdo gjykatë të shkallës së parë, të apelit dhe të gjykatave administrative, si dhe caktimin e kompetencave tokësore dhe selisë qendrore të gjykatave administrative”, i ndryshuar, të Presidentit të Republikës, organika të gjykatat e të gjitha niveleve paraqitet;

Gjithsej në organikë sipas dekretit janë; 408 gjyqtarë, nga të cilët;

- 19 gjyqtarë, Gjykata e Lartë,
- 102 gjyqtarë, Gjykatat e apeleve,
- 251 gjyqtarë, Gjykata e rretheve gjyqësore,

- **36 gjyqtarë**, Gjykata Administrative shkalla e parë,

Gjithsej, aktualisht që ushtrojnë detyrën janë; **361 gjyqtarë**, nga të cilët:

- **5 gjyqtarë**, Gjykata e Lartë,
- **95 gjyqtarë**, Gjykatat e apeleve,
- **232 gjyqtarë**, Gjykata e rretheve gjyqësore,
- **29 gjyqtarë**, Gjykata Administrative, shkalla e parë,

Gjithsej, aktualisht vende vakant, në sistem janë; **47 vende vakant**, nga të cilët,

- **14 gjyqtarë**, Gjykata e Lartë,
- **7 vende**, Gjykatat e apeleve,
- **19 vende**, Gjykata e rretheve gjyqësore,
- **7 vende**, Gjykata Administrative, shkalla e parë,

Në mënyrë analitike, të gjitha gjykatat të ndara sipas shkallëve, për numrin sipas dekretit, numrit sipas organikës aktuale, si dhe numri i vakancave, paraqiten sipas pasqyrave të mëposhtme:

Pasqyra e organikës së Gjykatës së Lartë

Nr.	Gjykata	Gjyqtarë		Vakant	Gjyqtar të shkarkuar nga KPK (pa formë të prerë)
		Organika	Fakti		
1.	Gjykata e Lartë	19	5	14	1

Në Gjykatën e Lartë, organika është **19 gjyqtarë**, **5 gjyqtarë** aktualisht në organikë (3 gjyqtarë ushtrojnë efektivisht detyrën, 1 gjyqtar është anëtar KLGJ dhe 1 gjyqtar të shkarkuar nga KPK, pa formë të prerë), **14 vende** vakante.

Pasqyra e organikës së Gjykatave të Apeleve

Nr.	Gjykata e Apelit	Gjyqtarë		Vakant	Gjyqtar të shkarkuar nga KPK (pa formë të prerë)
		Organika	Fakti		
1.	Gjykata e Apelit Durrës	13	10	3	
2.	Gjykata e Apelit Gjirokastrë	6	6	-	
3.	Gjykata e Apelit Vlorë	12	10	2	1
4.	Gjykata e Apelit Shkodër	10	10	-	1
5.	Gjykata e Apelit Tiranë	31	29	2	3
6.	Gjykata e Apelit Korçë	6	6	-	2
7.	Gjykata e Apelit Adm Tiranë	13	13	-	
8.	Gjykata e Apelit Krime Renda	11	11	-	1
		102	95	7	8

Në Gjykatat e Apeleve, organika është **102 gjyqtarë**, **95 gjyqtarë** aktualisht në organikë (85 gjyqtarë ushtrojnë efektivisht detyrën, 2 gjyqtarë janë anëtarë në KLGJ dhe 8 gjyqtarë të shkarkuar nga KPK, pa formë të prerë), **7 vende** vakante.

Pasqyra e organikës së Gjykatave të rretheve Gjyqësore

Nr.	Gjykata e Rrethit Gjyqësor	Gjyqtarë	Vakant	Gjyqtar të shkarkuar
-----	----------------------------	----------	--------	----------------------

		<i>Organika</i>	<i>Fakti</i>	<i>Vakant</i>	<i>nga KPK (pa formë të prerë)</i>
1.	Gjykata e Rrethit Berat	10	9	1	1
2.	Gjykata e Rrethit Dibër	4	3	1	
3.	Gjykata e Rrethit Durrës	17	15	2	
4.	Gjykata e Rrethit Elbasan	14	12	2	
5.	Gjykata e Rrethit Fier	14	14	-	
6.	Gjykata e Rrethit Gjirokastrë	6	6	-	1
7.	Gjykata e Rrethit Kavajë	4	4	-	
8.	Gjykata e Rrethit Korçë	14	12	2	1
9.	Gjykata e Rrethit Krujë	4	3	1	
10.	Gjykata e Rrethit Kukës	4	2	2	
11.	Gjykata e Rrethit Kurbin	4	4	-	1
12.	Gjykata e Rrethit Lezhë	5	5	-	
13.	Gjykata e Rrethit Lushnje	5	4	1	
14.	Gjykata e Rrethit Mat	4	4	-	
15.	Gjykata e Rrethit Përmet	4	4	-	1
16.	Gjykata e Rrethit Pogradec	4	4	-	
17.	Gjykata e Rrethit Pukë	4	3	1	1
18.	Gjykata e Rrethit Sarandë	6	6	-	1
19.	Gjykata e Rrethit Shkodër	14	13	1	1
20.	Gjykata e Rrethit Tiranë	76	73	3	1
21.	Gjykata e Rrethit Tropojë	4	3	1	1
22.	Gjykata e Rrethit Vlorë	14	14	-	
23.	Gjykata Sh.I.Krime te Rënda	16	15	1	
		251	232	19	10

Në Gjykatat e rretheve gjyqësore, organika është 251 gjyqtarë, 232 gjyqtarë aktualisht në organikë (219 gjyqtarë ushtrojnë efektivisht detyrën, 3 gjyqtarë janë anëtarë në KLGJ-ë dhe 10 gjyqtar të shkarkuar nga KPK, pa formë të prerë), 19 vende vakante.

Pasqyra e organikës së Gjykatave Administrative të Shkallës së Parë

<i>Nr.</i>	<i>Gjykata Administrative</i>	<i>Gjyqtarë</i>		<i>Vakant</i>	<i>Gjyqtar të shkarkuar nga KPK (pa formë të prerë)</i>
		<i>Organika</i>	<i>Fakti</i>		
1.	Gjykata Adm. Shkalla e Parë Durrës	4	3	1	
2.	Gjykata Adm. Shkalla e Parë Shkodër	4	2	2	1
3.	Gjykata Adm. Shkalla e Parë Korçë	4	2	2	
4.	Gjykata Adm. Shkalla e Parë Vlorë	4	4	-	
5.	Gjykata Adm. Shkalla Parë Gjirokastrë	4	2	2	
6.	Gjykata Adm. Shkalla e Parë Tiranë	16	16	-	
		36	29	7	1

Në Gjykatat Administrative Shkalla e Parë, organika është 36 gjyqtarë, 29 gjyqtarë aktualisht në organikë (28 gjyqtarë ushtrojnë efektivisht detyrën, 1 gjyqtar të shkarkuar nga KPK, pa formë të prerë), 7 vende vakante.

Gjatë vitit 2018 janë larguar nga sistemi gjyqësor, me dorëheqje ose kanë mbushur moshën për pension 6 gjyqtarë, si dhe është futur në sistem vetëm 1 gjyqtar.

Gjatë vitit 2018 dhe fillim vitit 2019, nga vendimmarrja e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, të shkarkuar dhe në pritje të vendimit përfundimtar janë gjithsej 20 gjyqtarë, ndërkohë nga Kolegji i Posaçëm i Apelit janë shkarkuar 7 gjyqtarë.

4.2.6 Vlerësim i situatës për burimet njerëzore të administratës gjyqësore

Numri i punonjësve për Pushtetin Gjyqësor miratohet çdo vit me ligjin e buxhetit të shtetit. Për vitin 2019, numri i miratuar është 1389 punonjës, nga të cilët 408 gjyqtarë dhe 981 administratë gjyqësore (këtu përfshihet edhe 21 punonjës struktura ish – ZABGJ).

Tendenca e numrit të punonjësve të administratës gjyqësore ka qenë në rritje të lehtë nga viti në vit, sikurse shihet në tabelën e mësipërme. Megjithatë kjo rritje ka qenë e pamjaftueshme për plotësimin e nevojave reale që gjykatat kanë patur e vazhdojnë të kenë për punonjës administratë gjyqësore. Pjesërisht këto nevoja janë zgjidhur me punonjës me kontratë. Për vitin 2019 janë miratuar 71 punonjës me kontratë.

Raporti aktual gjyqtar/administratë gjyqësore është 1 gjyqtar/2.4 administratë gjyqësore.

Në raportin e Komisionit Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ), të publikuar në muajin mars 2018, mesatarja e vendeve të marra në analizë nga CEPEJ, e raportit të mësipërm është 1 gjyqtar/3.9 administratë gjyqësore. (raporti i CEPEJ f.159.)⁵⁴

Bazuar në Ligjin nr. 98/2016 “Për organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, neni 41 parashikon se Administrata Gjyqësore realizon misionin e saj nëpërmjet shërbimeve: a) shërbime gjyqësore b) shërbime administrative c) shërbime mbështetëse.

KLGG-ja ka përgatitur paketën e plotë për nevojat që ka gjyqësori për punonjës administratë gjyqësore shtesë, sipas detyrimeve që rrjedhin nga ligji i mësipërm.

Nga kjo analizë rezulton se :

- Numri organik i pushtetit gjyqësor, për tre nivelet e gjykatave të shkallës së parë; apeleve dhe gjykatës së lartë, në përmbushje të detyrimit ligjor, duhet të jetë 1681 punonjës, ose 313 punonjës më shumë.

Në mënyrë tabelore numri aktual dhe nevojat për punonjës shtesë të administratës gjyqësore janë:

Nr.	Pozicioni i punës	Nr. aktual i punonjësve	Nr. sipas parashikimeve ligjore	Kërkesat për punonjës shtesë
1	Kancelar	37	37	
2	Gjykata e lartë (administratë)	112	112	
3	Ndihmës ligjor	31	51	20
4	Kryetar Dege Buxheti	37	37	
5	Kryesekretar	22	38	16
6	Sekretar gjyqësor	408	430	22
7	Ekonomist	6	12	6
8	Magaznier/ arkëtar	9	37	28
9	ZMP	3	37	34
10	IT	39	39	0

⁵⁴ <https://rm.coe.int/rapport-avec-couv-18-09-2018-en/16808def9c>

11	Arkivist	39	39	0
12	Punonjës sigurie	36	41	5
13	Burimet njerëzore	2	2	0
14	Ftues	56	56	0
15	Nëpunës gjyqësor	0	177	177
16	Shofer	41	41	0
17	Sanitare	47	47	0
18	Mirëmbajtës	15	40	25
19	Punonjësit shtesë të miratuar me ligjin e buxhetit për vitin 2019 i pa detajuar	20		-20
	Totali	960	1273	313

Miratimi i hartës së re gjyqësore do të shoqërohet me një analizë gjithëpërfshirëse mbi strukturën, funksionimin, statusin e administratës gjyqësore si dhe do të përcaktojë të nevojat përfundimtare për punonjës të administratës gjyqësore.

Realizimi i misionit dhe objektivave të KLGJ-së të përcaktuara në draft-strategjinë e saj kërkon sigurimin e burimeve të mjaftueshme e të përshtatshme financiare dhe njerëzore. Ndërkohë që nevojat e vlerësuara nga ish-ZABGJ për burime njerëzore (administratë gjyqësore) kanë qenë për rreth 300 punonjës, por duke marrë në konsideratë kushtëzimet buxhetore u kërkuan vetëm 83 punonjës gjyqësorë shtesë për vitin 2018, Kuvendi e pa të arsyeshme të miratonte vetëm 20 punonjës.

4.2.7 *Përmbledhje e gjetjeve kryesore mbi burimet*

Në vlerësim të situatës buxhetore dhe të burimeve njerëzore **evidentojmë këto përfundime:**

Në shpenzime korrente – Të sigurohen fondet e nevojshme buxhetore për të garantuar aktivitetin financiar të KLGJ-së dhe gjykatave në përputhje me strukturat organike të miratuara me ligj si dhe për punonjësit shtesë të administratës gjyqësore që do të kërkohen për periudhën afat-mesme.

Në shpenzime kapitale:

Përmirësimi i infrastrukturës ndërtimore

Duke synuar arritjen e një niveli të njëjtë standardesh në të gjitha godinat e gjykatave, mbetet e domosdoshme ndërhyrja në 16 gjykata që nuk plotësojnë standardet.

Investimi për godinat e reja të gjykatave të Tiranës (Gjykatës së Lartë, Gjykatës së Apelit dhe Rrethit Gjyqësor Tiranë) është e domosdoshme të trajtohet me prioritet. Nga përllogaritjet paraprake, ndërtimi i këtyre gjykatave kërkon një buxhet rreth 29 milion euro.

Miratimi i hartës gjyqësore do të saktësojë numrin e gjykatave dhe mbi këtë do të kryhen studimet përkatëse dhe do të përcaktohet vlera e investimit sipas rastit.

Zgjidhja e çështjes së sheshit të ndërtimit për godinat që do të ndërtohen të reja apo e objekteve që mund t'i nënshtrohen rikonstruksionit të plotë për t'u përshtatur për godina

gjykate kërkon një vëmendje të shtuar, pasi sikurse dihet sistemi gjyqësor nuk zotëron prona.

Nevoja për sisteme TIK dhe infrastrukturës elektronike të gjykatave

Përmirësimi i kushteve të punës, solemnitetit dhe sigurisë në gjykata.

Kompletimi me pajisje mobilie për zyrat, sallat e ambiente të tjera; si edhe rinovimi i pajisjeve të amortizuara çdo vit.

Në mbështetje të parashtrimit mbi gjendjen e infrastrukturës së gjykatave, duke ju referuar qëllimit afatmesëm e strategjik, për të përshpejtuar reformën në pushtetin gjyqësor; për zbatimin e standardeve për ekselencë gjyqësore, për ofrimin e shërbimeve gjyqësore të shpejta, transparente, eficiente dhe të paanshme, për përmirësimin e solemnitetit dhe rritjes së sigurisë të të gjitha palëve në gjykatë, kërkohet rritje e konsiderueshme dhe e qëndrueshme e buxhetit në investime. Buxheti prej 1,2 milion euro në investime në vit, është e qartë që nuk i përgjigjet kërkesave dhe qëllimeve. Kjo ka qenë vlera e investimeve për vitet 2017-2018-2019, por sigurisht e shikojmë të lidhur me periudhën deri në krijimin e KLGJ-së.

Për më tej mendojmë se investimet për Pushtetin Gjyqësor duhet të jenë adekuate në mbështetje të realizimit të funksionit të KLGJ-së, për një qeverisje të përgjegjshme, eficiente dhe transparente të sistemit gjyqësor si dhe adekuate në mbështetje të punës së gjykatës për arritjen e një shërbimi cilësor për publikun. E gjithë kjo do të çojë drejt qëllimit final për rritjen e besimit të publikut te drejtësia.

Mungesa e investimeve rrezikon të bëhet pengesë për të çuar përpara proceset e Reformës në Drejtësi, të filluara tashmë.

Në burime njerëzore për Administratën Gjyqësore

Kërkesat për mbi 300 punonjës shtesë si ndihmësit ligjorë, nëpunës gjyqësorë, punonjës për marrëdhëniet me publikun, etj., mund të plotësohen gradualisht duke u bërë pjesë e planit strategjik të KLGJ-së.

Me numrin e ri të stafit administrativ raporti i gjyqtarëve me stafin administrativ do të jetë 1:3.1 për gjithë gjyqësorin, nga 1:2.4 që është aktualisht.

5 KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Duke mbajtur në konsideratë detyrimet ligjore që burojnë nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe kuadri ligjor në zbatim të saj, duke marrë angazhimin për të garantuar një mirëqeverisje të sistemit gjyqësor në tërësi, KLGJ raporton për masat e marra që nga momenti i konstituimit të saj, duke theksuar veçanërisht arritjet e mëposhtme:

1. Në mbledhjen e datës 20 dhjetor 2018 u ngrit Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe u zgjodhën organet drejtuese të tij. Gjithashtu brenda muajit të parë, Këshilli ngriti katër komisionet e tij të përhershme: Komisioni për Planifikimin Strategjik, Administrimin dhe Buxhetin; Komisioni Disiplinor; Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale; Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Gjithashtu, tashmë është miratuar struktura organizative e administratës së KLGJ-së, si dhe për çështje të veçanta janë ngritur katër komisione të përkohshme, përkatësisht: *Komisioni i përkohshëm për vlerësimin etik dhe profesional në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe subjekteve të tjera të rivlerësimit; Komisioni i përkohshëm për verifikimin e plotësisë të kriterëve të kandidatëve për këshilltarë dhe ndihmës ligjorë që do të pranohen për të ndjekur programin e formimit fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës për vitin akademik 2019-2020; Komisioni i përkohshëm për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të kryeinspektorit të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë për arkivimin e ankesës ose pushimin e hetimit ndaj një gjyqtari; Komisionit të Përkohshëm për Vlerësimin e Statusit Individual dhe karrierën e inspektorëve të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë.*
2. Duke mbajtur parasysh rëndësinë e procesit të vettingut, KLGJ u angazhua menjëherë për të ngritur strukturën përkatëse “*Komisioni i përkohshëm për vlerësimin etik dhe profesional në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe subjekteve të tjera të rivlerësimit*”, si dhe miratoi rregullat e funksionimit të këtij komisioni për të garantuar vijueshmërinë e bashkëpunimit me organet e rivlerësimit kalimtar. Në kuadër të këtij procesi, KLGJ bashkëpunon intensivisht me gjykatat e vendit për marrjen e dokumentacionit, organizimin e shorteve për gjyqtarët nën vlerësim, përpunimin dhe hartimin e raporteve të vlerësimit nga inspektorët dhe respektimin e procedurave të komunikimit dhe dorëzimit të informacionit pranë institucioneve përgjegjëse.
3. Marrja e një numri masash emergjente për të lehtësuar efektet e krijuara në gjykatat e vendit nga tej zgjatja e kohës së krijimit të KLGJ, periudhës tranzitore të funksionimit të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë, si dhe procesit të vettingut.
 - a. Duke nisur nga numri i lartë i kërkesave të kryetarëve të gjykatave (184 kërkesa) për plotësimin e trupave gjyqësore, KLGJ operoi me miratimin e rregullave për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve të caktuara në gjykata të ndryshme nga ato ku ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme. Kjo nismë u mor si masë emergjente pas mos përgjigjes nga ana e gjyqtarëve për t’u përfshirë në skemën e delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të miratuar dhe shpallur nga KLGJ sipas kërkesave të ligjit nr.96/2016 “*Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë*”. Nga 327 kërkesa janë deleguar 427 gjyqtarë në rang vendi.
 - b. Në kushtet e mungesës së ushtrimit të funksionit drejtues në gjykata nga kryetarët të cilët u shkarkuan nga institucionet e rivlerësimit, si dhe në kushtet

kur në këto gjykata nuk kishte zëvendëskryetarë të zgjedhur, KLGJ ndërhyri duke miratuar rregullat për mënyrën e zgjedhjes së zëvendëskryetarëve pranë gjykatave në nevojë. Nga 37 gjykata të nivelit të parë dhe të apelit, janë zgjedhur zëvendëskryetarë në 36 prej tyre.

- c. Harta gjyqësore qëndron si çelësi i zgjidhjes të problemeve që lidhen me ngarkesën e punës, delegimet, aksesin, kostot, eficientën, etj. Nisur nga ky vlerësim, në muajin Shkurt 2019 është ngritur një grup ndërinstytucional pune me përfaqësues nga gjykatat e vendit, KLGJ, Ministria e Drejtësisë dhe partnerë ndërkombëtarë (Këshilli i Evropës dhe EURALIUS dhe Projekti “Drejtësi për të Gjithë”- JUST/USAID) i cili është i angazhuar me vlerësimin e situatës faktike dhe pritet që brenda 6 muajve nga momenti i krijimit ky grup pune të prezantojë propozimet e tij lidhur me riorganizimin e ri gjyqësor.
- d. Bazuar në ligjin nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, neni 83, Këshilli i Lartë Gjyqësor, brenda gjashtë muajve nga krijimi i tij, verifikon plotësimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të pozicionit, si dhe bën verifikimin e figurës dhe të pasurisë së kancelarëve në detyrë. Deri më tani është bërë verifikimi, paraprak i të gjithë kancelarëve në detyrë 37 kancelarë (8 kancelarë nga gjykatat e apeleve, 23 kancelarë nga gjykatat e rretheve gjyqësore, 6 kancelarë nga gjykatat e shkallëve të para administrative).

4. Zgjidhja e ngërçit për caktimin e numrit të magistratëve për të vijuar trajnimin fillestar pranë Shkollës së Magistraturës ishte një detyrim ligjor për KLGJ por edhe një dosmosdoshmëri për sistemin gjyqësor i cili shfaq probleme akute në numrin e gjyqtarëve në kushtet e largimeve nga sistemi nëpërmjet dorëheqjeve, daljes në pension, por kryesisht për shkarkimeve nga detyra si pjesë e procesit të vettingut. Deri më tani ka ligjërisht 47 vende vakante në sistem dhe 25 procese të cilat nuk kanë përfunduar me vendim përfundimtar nga Kolegji i Posaçëm i Apelit. Edhe pse gjyqtarët të cilët shkarkohen nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit nuk janë efektivisht në detyrë, ligjërisht këto pozicione nuk konsiderohen si vende vakante, si dhe nga ana financiare këto subjekte përfitojnë 75% të pagës mujore (pra me efekte financiare mbi buxhetin e shtetit).

Për vitin 2019 Këshilli aprovoi një numër prej 25 kandidatësh magistrat dhe 25 ndihmës ligjorë të cilët do të ndjekin Shkollën e Magistraturës (SHM) duke mbajtur në konsideratë kapacitetet e kufizuara të SHM aktualisht. Në përfundim të konkursit pranë kësaj shkolle, për profilin gjyqtar, kanë fituar 28 magistratë dhe 6 ndihmësa ligjorë⁵⁵. Në të njëjtën kohë KLGJ ka nisur procesin për emërimin e magistratëve që kanë përfunduar studimet në vitin 2018 duke kërkuar bashkëpunimin e institucioneve përgjegjëse për dhënien e informacionit mbi pastërtinë e figurës dhe integritetit të tyre.

5. Bazuar në ndryshimet Kushtetuese të cilat kërkojnë transformimin e Gjykatave të Krimeve të Rënda në Gjykata të Posaçme që Gjykojnë Vepra Penale të Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, KLGJ ka nisur procesin e caktimit të përkohshëm të gjyqtarëve pranë këtyre gjykatave, duke kërkuar nga gjyqtarët aktualë dhënien e pëlqimit të tyre dhe familjarëve për të vijuar konkurrimin për emërimin në këto nivele. Për Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda të

⁵⁵ Në vendimin nr. 17 datë 29.1.2019 pika 1 shprehja “c” të KLGJ është parashikuar se në rast se, në përfundim të procedurës së aplikimeve për pranimin në formimin fillestar, nuk ka kërkesa që plotësojnë numrin e planifikuar të kandidatëve për këshilltarë dhe ndihmës ligjorë, kuotat për këto të fundit do t’i shtohen kandidatëve për magistratë të profilit gjyqtar”.

gjithë gjyqtarët kanë dhënë pëlqimin e tyre (14 nga 15 gjyqtarë)⁵⁶. Ndërkohë që nga Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda nga 11 gjyqtarë, 8 kanë shprehur pëlqimin deri më tani. Emërimi i këtyre gjyqtarëve në Gjykatën e Posaçme do të kryhet pas kalimit të procesit të rivlerësimit kalimtar nga ana e tyre.

6. Duke mbajtur parasysh efektet e procesit të rivlerësimit kalimtar për Gjykatën e Lartë, ku aktualisht ushtrojnë detyrën vetëm 3 nga 19 gjyqtarë, KLGJ është fokusuar në hartimin e tre rregulloreve të nevojshme për plotësimin e trupës së kësaj gjykate. Komisioni për Zhvillimin e Karrierës aktualisht ka përfunduar hartimin e rregullave për kriteret dhe procedurën e caktimit të anëtarëve jo gjyqtarë, për promovimin e anëtarëve gjyqtarë pranë kësaj gjykate, dhe rregullave që lidhen me verifikimin e pasurisë dhe figurës për kandidatët magistratë, ndërkohë pritet që në ditët në vijim këto rregullore të shqyrtohen dhe miratohen në mbledhjen plenare të Këshillit.
7. Nisur nga situata e krijuar, kur Inspektori i Lartë i Drejtësisë (ILD) nuk është krijuar ende, ndërkohë që ligji nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” parashikon që një pjesë e inspektorëve të ish-KLD-së të transferoheshin pranë KLGJ-së dhe një pjesë pranë ILD-së, Këshilli krijoi një komision të posaçëm “Për vlerësimin e statusit individual dhe karrierën e inspektorëve të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë”. Ky komision është duke vlerësuar se cili nga inspektorët mban statusin e magistratit dhe cilët nga këta inspektorë do të jenë pjesë e administratës së saj, si dhe cilët duhet të transferohen në ILD. Gjithashtu, duke mbajtur parasysh se ndaj vendimeve të Kryeinspektorit të ish-KLD ka një numër prej 183 ankesash nga ana e qytetarëve, KLGJ vendosi ngritjen e një komisioni të posaçëm për shqyrtimin e këtyre ankimeve.
8. Në funksion të garantimit të transparencës së KLGJ, si dhe duke mbajtur si prioritet informimin e publikut mbi veprimtarinë dhe rezultatet e arritura, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka marrë angazhimin për të krijuar një portal *online* të përkohshëm, si dhe më datë 24 prill 2019 caktoi një nga anëtarët e tij për të mbuluar marrëdhëniet me publikun. Anëtari i cili do ta kryejë këtë funksion është zoti Erjon Muharremaj.
9. Si detyrim ligjor i Komisionit për Planifikimin Strategjik, Administrimin dhe Buxhetin por dhe në funksion të orientimit strategjik të vetë KLGJ-së dhe marrjes së masave prioritare për përmirësimin e sistemit gjyqësor, që nga momenti i krijimit, Këshilli ka punuar për hartimin e Planit Strategjik 2-vjeçar dhe Planin e Veprimit në zbatim të strategjisë. Kjo strategji është hartuar në përputhje me Strategjinë Ndërsektoriale të Drejtësisë për të realizuar qëllimet e synuara nga reforma në drejtësi dhe duke saktësuar veprimet dhe objektivat që KLGJ synon të arrijë në një afat imediat. Strategjia dhe Plani i Veprimit janë tashmë në fazë finalizimi dhe pas nënshtrimit të një konsultimi publik dhe me aktorët e interesit do të miratohen nga Këshilli brenda muajit maj 2019. Për hartimin e kësaj strategjie është punuar ngushtësisht me partnerët tanë ndërkombëtarë veçanërisht me projektin “Drejtësi për të Gjithë” (JUST/USAID).

⁵⁶ Një gjyqtar është tashmë anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor.

E vetëdijshme për mandatin e gjerë qeverisës mbi sistemin gjyqësor shqiptar, e ndërgjegjshme për problematikat e së shkuarës dhe sfidat e së ardhmes, angazhohet gjatë viti 2019 për të përmbushur një sërë detyrash, si më poshtë vijon:

- Miratimin e të gjitha akteve nënligjore të nevojshme për funksionalizimin e vetë KLGJ-së dhe adresimin e nevojave imediate për përmirësimin e vazhdueshëm të veprimtarisë të gjykatave;
- Bashkëpunimin me organet e rivlerësimit kalimtar për të shpejtuar zgjidhjen përfundimtare të ankimeve, duke ulur kështu impaktin e këtij procesi në lidhje me vendet vakante në gjykata dhe efektet financiare që i krijohen buxhetit të shtetit nga pezullimet nga detyra;
- Vijimin e procesit të vlerësimit të gjyqtarëve për periudhën 2010-2012 i cili ka mbetur i papërfunduar;
- Përfundimin e analizës për rikonfigurimin e hartës gjyqësore, duke mbajtur në konsideratë se ky është një proces i kushtueshëm, i shtrirë në kohë dhe që mund të kërkojë edhe masa të përkohshme si shkrija e disa gjykatave me disa të tjera, krijimi i degëve të gjykatave të përkohshme, transferimi i gjyqtarëve nga një degë në një tjetër, standardet evropiane që aspirojmë për raportin gjyqtar/popullsi etj.
- Nisjen e një analize tërësore për problemet e sistemit dhe hartimi i masave afatmesme që mund të sjellin përmirësimin e efijencës së gjykatave;
- Përfundimin e emërimit dhe caktimit në detyrë të magjistratëve që kanë përfunduar studimet në vitin 2018, si dhe mbështetja e Shkollës së Magjistraturës për ngritjen e kapaciteteve dhe mundësisht rritjen e kuotave për t’iu përgjigjur nevojave të sistemit sidomos pas efekteve të reformës;
- Hartimin e rregullores së brendshme të Këshillit të Lartë Gjyqësor duke saktësuar edhe funksionimin e komisioneve të përhershme;
- Zgjedhjen e Këshilltarit të Etikës për hartimin e rregullave të etikës;
- Përfundimin e rregullave dhe hapjen e procesit të emërimit për anëtarët e Gjykatës së Lartë, të cilat janë tashmë në fazë finalizimi nga Komisioni përkatës dhe pritet të miratohen nga KLGJ;
- Bashkëpunimin me Këshillin e Lartë të Prokurorisë për të mundësuar ngritjen e Gjykatave të Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar duke emëruar me prioritet gjyqtarët të cilët konfirmohen në detyrë nga organet e vettingut;
- Mbështetjen për Këshillat e Gjykatave si organe të reja që do t’i shërbejnë mirëadministrimit në çdo gjykatë;
- Bashkëpunimin me Ministrinë e Drejtësisë për kalimin e kompetencave në lidhje me administrimin e gjykatave dhe sistemet e teknologjisë së informacionit parashikuar në nenin 277, të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë.
- Krijimin e portalit elektronik të Këshillit të Lartë Gjyqësor i cili krijon lidhjen me faqen e internetit të çdo gjykate me qëllim rritjen e transparencës dhe aksesin e publikut në gjykata;

Për sa më sipër, Këshilli i Lartë Gjyqësor kërkon mbështetjen e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë në lidhje me:

- Rishikimin e kuadrit ligjor dhe plotësimin e vakumit të krijuar për shkak të shfuqizimit të disa dispozitave nga Gjykata Kushtetuese në ligjin nr.115/2016

dhe ligjin nr.96/2016, si dhe ndryshimeve të nevojshme që mund të lindin gjatë zbatimit të tyre në praktikë.⁵⁷

- Rritjen e burimeve njerëzore në gjykata me **të paktën 150 punonjës** për administratën gjyqësore në shkallë vendi kur nevojat e raportuara vlerësohen në të paktën 330 punonjës.
- Mbështetjen financiare në investime për rikonstrukcionin apo ndërtimin e gjykatave, si dhe të sistemeve të teknologjisë së informacionit, veçanërisht të Sistemit të Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore.

⁵⁷ Vendimi nr.34, datë 10.04.2017; Vendimi nr. 41, datë 16.05.2017; Vendimi nr.78, datë 12.12.2017.

